



MANUAL PËR MËSUESIN

Mësimdhënia dhe të nxënit në edukimin joformal

Hartuar në kuadrin e projektit "Program përfshirës mbi eliminimin e trafikimit të fëmijëve", mundësuar nga Programi Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve (ILO-IPEC)



Tiranë, 2006

Autore:

Albana Markja

Specialiste në Qendrën e Trajnimit dhe Kualifikimit për Arsimin

Design & layout: Algerta Kambo

Ky manual është realizuar në kuadrin e projektit “Program përfshirës mbi eliminimin e trafikimit të fëmijëve në tre qytete të përzgjedhura të Shqipërisë” – Korçë, Elbasan dhe Berat, bashkëpunim i NPF Korçë me Programin Ndërkombëtar për Eliminimin e Punës së Fëmijëve të Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ILO-IPEC) në Tiranë

Mirënjohje për mbështetjen dhe sugjerimet e dhëna nga organizatat e NPF në Korçë, Elbasan e Berat si dhe të gjithë mësuesve që punojnë me klasat e shkollimit joformal në këto rrethe.

Përmbajtja

PJESA I: EDUKIMI JOFORMAL DHE KURRIKULA	6
I.1 Edukimi joformal dhe avantazhet e tij	6
I.2 Edukimi joformal – shkollim gjithëpërfshirës	7
I.3 Kurrikula në edukimin joformal	10
I.4 Objektivat kros dhe ekstrakurrikularë në edukimin joformal	15
PJESA E II: MËSIMDHËNIA DHE TË NXËNËT EFEKTIV NË EDUKIMIN JOFORMAL	19
II.1 Mësuesi dhe mësimdhënia efektive	19
II.2 Procesi i të nxënit	22
II.3 Veprimtaritë dhe metodat me në qendër nxënësin	24
II.4 Metoda dhe teknika mësimdhënëse	27
II.5 Menaxhimi i klasës	30
II.6 Motivimi i nxënësve	30
II.7 Planifikimi i mësimdhënies	30
PJESA E III: VEPRIMTARI TË NDRYSHME PËR NXËNËSIT	32

Hyrje

Manuali “Mësimdhënia dhe të nxënit në edukimin joformal” synon tu vijë në ndihmë të gjithë mësuesve që punojnë me klasat e edukimit joformal në rrethet Korçë, Elbasan dhe Berat. Nëpërmjet tij është bërë një përpjekje për të përm-bushur një lloj boshllëku të konstatuar në kurrikulën dhe mënyrën e mësim-dhënies në klasat e edukimit joformal. Ky manual mendohet të jetë një pjesë plotësuese e punës së madhe që bëjnë mësuesit që zhvillojnë mësim në këto klasa dhe punojnë me fëmijë që punojnë apo në rrezik për t’u punësuar si dhe ata që kanë qenë trafikuar.

Hartimi i manualit për këta mësues është bërë i mundur në sajë të projektit “Program përfshirës mbi eliminimin e trafikimit të fëmijëve në tre qytete të përzgjedhura të Shqipërisë” – Korçë, Elbasan dhe Berat, financuar nga Zyra ICO - IPEC në Shqipëri. Projekti, i zbatuar nga organizata Ndihmë për Fëmijët në Korçë, ka zhvilluar një program të gjerë veprimesh si një përgjigje efektive ndaj natyrës shumë planëshe të problemit të trafikimit të fëmijëve nëpërmjet zhvillimit të një strategjie gjithëpërfshirëse dhe shumë sektoriale. Ky program veprimesh përfshin edhe ndërhyrjen përmes shkollimit joformal e cila do të aftësojë fëmijët në rrezik të trafikimit dhe ata që punojnë për të kapur ritmin e bashkëmoshatarëve që ndjekin shkollën formale.

Çfarë do të gjeni në këtë manual




Manuali “Mësimdhënia dhe të nxënit në edukimin joformal” ofron alternativa për një gamë të gjere problemesh që lidhen me kurrikulën, mësimdhënien dhe të nxënit në edukimin joformal. Ai është i organizuar në kapituj. Secili prej tyre synon të zbërthejë një aspekt të edukimit përmes trajtimit të koncepteve dhe ilustrimit me shembuj veprimtarish praktike që mund të zhvillohen në klasë.

- o *Kapitulli I* trajton kurrikulën në edukimin joformal. Ai përshkohet nga ideja që përmbajtjen e kurrikulave lëndore edukimi joformal duhet ta pasurojë përmes veprimtarive kroskurrikulare dhe ekstrakurrikulare.
- o *Kapitulli II* trajton veçoritë e mësimdhënies efektive dhe të nxënit të nxënësve. Këto përcillen përmes trajtimit të metodave dhe teknikave të mësimdhënies si dhe veçorive të të nxënit të nxënësve në këtë lloj edukimi.
- o *Kapitulli III* ofron një sërë veprimtarish lëndore apo ekstrakurrikulare që mund të zhvillohen me lehtësi nga mësuesit pasi ato janë tashmë të planifikuara me të gjithë etapat e një ore mësimore.

Për përcjelljen e informacionit është zgjedhur një mënyrë efektive përmes ilustrimit hap pas hapi me anë të veprimtarive praktike. Manuali ofron rreth 25 veprimtari për nxënësit.

Si mund ta përdorni këtë manual

Për ta bërë lehtësisht të përdorshëm materiali i përcjellë në këtë manual është i shoqëruar me shenja të tilla si:

-  Tregon informacion kyç, idetë kryesore të pjesës që vijon
-  Tregon pjesë të informacionit që janë më të rëndësishme për tu mbajtur mend nga mësuesi
-  Tregon një veprimtari praktike që mund të zhvillohet me nxënësit në klasë.

Pjesa I. Edukimi joformal dhe kurrikula



Ju kujtojmë se:

- *Edukimi joformal është një formë e edukimit që i mundëson fëmijëve të ecin me ritmin normal të bashkëmoshatarëve*
- *Edukimi joformal i krijon hapësirë mësuesit për të qenë ideator dhe krijues i veprimtarive në klasë*
- *Gjithëpërfshirje në edukimin joformal do të thotë njohje dhe pranim i ndryshimeve mes fëmijëve dhe sigurim i edukimit për të gjithë*
- *Edukimi joformal shtron nevojën e një kurrikule cilësore që do të thotë:*
 - *Qëllime dhe objektiva të gjëra*
 - *Strukturë fleksibël*
 - *Përmbajtje e pasur*
 - *Trajtime përmes veprimtarive praktike*
- *Përmes trajtimeve lëndore kurrikula realizon objektiva që trajtojnë çështje që lidhen me fenomenet sociale të prekshme për fëmijët*

I.1 EDUKIMI JOFORMAL DHE AVANTAZHET E TIJ

Tashmë në arsimin tonë pranohet plotësisht se një përpjekje për zhvillim, e orientuar drejt edukimit për të gjithë, është mënyra më efektive për të sulmuar tërësinë e shkaqeve thelbësore të trafikimit dhe punës së fëmijëve dhe për t'i eliminuar ato në vazhdimësi.

Përvoja e deritanishme ka treguar eksperiencë pozitive në përdorimin e edukimit për të luftuar trafikimin dhe punën e fëmijëve. Në këtë kuadër aplikohet dhe edukimi joformal. Fëmijëve që frekuentojnë klasat joformale iu jepet një mundësi për të "arritur" shokët që e kanë filluar shkollën në moshën e duhur apo e kanë ndjekur atë rregullisht.

Përvoja ka treguar, gjithashtu, se edukimi joformal i izoluar nuk siguron gjithmonë mundësi për edukimin e mëtejshëm të fëmijës, gjë që tregon domosdoshmërinë e integritit të edukimit joformal në shkollat formale. Kjo dhe për faktin se Edukimi joformal i jep nxënësve që nuk frekuentojnë rregullisht shkollën, *elementet bazë të shkrimit, leximit dhe nocionet matematikore.*

Sot në kuadrin e reformave kurrikulare po flitet gjithnjë e më shumë për lirinë akademike dhe pavarësinë e mësuesit në klasë. Klasat joformale janë vendet dhe hapësirat më të mira për t'i lënë vend mësuesit për të qenë krijues dhe ideator i përmbajtjes dhe veprimtarive të mësimdhënies. Kjo për shumë arsye:

- Nuk ka kurrikul të posaçme për mësimin në klasat joformale;
- Mësuesi duhet të planifikojë vetë për periudha të gjata kohe për informacionin

- dhe të gjitha veprimtaritë që do të zhvillohen.
- Koha e zhvillimit të mësimit në këto klasa nuk ka limite, gjë që do të thotë se mësuesi nuk është i kufizuar nga limiti kohor i mësimit në klasat formale.
- Veprimtaritë e zhvilluara në këto klasa mund të zgjasin dhe të shtrihen dhe në më shumë se një orë mësimore.
- Përmbajtja e orës mësimore në klasat joformale përcaktohet nga mësuesi që i drejton.
- Teknikat, metodat dhe strategjitë që përdoren në mësimdhënie dhe për të nxënëit janë të larmishme dhe ndërvepruese dhe shpesh me efektive se në klasat formale.
- Ora mësimore në klasat joformale është krejtësisht e shkëputur nga mësimi tradicional pasi në qendër të kësaj orë është fëmija me problematikën e tij.
- Mungesa e vlerësimit me notë i çliron fëmijët nga stresi dhe presioni i notës.

I.2 EDUKIMI JOFORMAL - SHKOLLIM GJITHËPËRFSHIRËS

Gjithëpërfshirja në klasat joformale është një proces që bën të mundur që të gjithë fëmijët, duke përfshirë edhe grupet e marginalizuara, të nxënë dhe të marrin pjesë në mënyrë efektive në procesin e të mësuarit. Për këtë arsye e gjithë shkolla duhet të ndryshojë për t'ju përshtatur diversitetit të nevojave të fëmijëve.

Padyshim që nxënësit që vijnë në këto klasa dhe që përfshihen në këtë lloj edukimi janë të ndryshëm. Në këtë mënyrë klasat ku punohet janë diverse. *Diversiteti* në këtë rast duhet të jetë kuptimi pozitiv i ndryshimeve të shumta që ekzistojnë brenda shoqërisë, duke përfshirë ndryshimet mbi bazën e moshës, gjinisë, pasurisë, paaftësisë, kulturës, fesë, vendbanimit, statusit shëndetësor, social dhe etik.

Prandaj gjithëpërfshirja është një term i lidhur ngushtë me diversitetin. *Gjithëpërfshirje në klasat joformale do të thotë njohje dhe pranim i ndryshimeve mes fëmijëve dhe përdorim pozitiv i këtij fakti për të siguruar një edukim për të gjithë në shkollën tonë**. Në rastin tonë gjithëpërfshirja ka të bëjë më shumë me fëmijët që kanë “pengesa në mësimnxënie dhe pjesëmarrjen aktive në procesin mësimor”.

Pra edukimi gjithëpërfshirës synon t'i drejtohet nevojave në të nxënë të të gjithë fëmijëve me fokus të veçantë te ata që janë më vulnerabël dhe të përjashtuar, duke përfshirë këtu dhe fëmijët e trafikuar, ato që punojnë dhe ato që janë në rrezik të punësohen.



Klasat gjithëpërfshirëse janë një mjedis që:

- I përgjigjen spektrit të gjerë të nevojave në të nxënë;
- Ndryshojnë dhe transformojnë mësimdhënien për t'iu përgjigjur diversitetit të nxënësve;
- Lejon si mësuesin ashtu dhe nxënësin të pranojë diversitetin dhe ta shohë atë si element pozitiv në edukim;
- Pranon dhe vlerëson ndryshimet

Për ta dhënë mesazhin e një klase apo shkolle gjithëpërfshirëse si dhe për të bërë që nxënësit e përfshirë në edukimin joformal të ndjehen të përfshirë në edukim dhe shkollë mund të planifikohen dhe zhvillohen një sërë veprimtarish që i bëjnë nxënësit të ndjehen mirë në procesin e edukimit.

*“Child Labour and Education” - IPEC draft training manual for education practitioners, October, 2005

Unë dhe kultura ime

Qëllimi: Të identifikohen aspekte të kulturës që ndikojnë sjelljet tona dhe nganjëherë na bëjnë ta kemi të vështirë të kuptojmë sjelljet e të tjerëve.

Objektivat: Në fund të kësaj veprimtarie nxënësit do të jenë të aftë të:

- dallojnë kultura të ndryshme;
- shpjegojnë se disa ndryshime mes njerëzve vijnë nga kultura dhe disa nga preferencat personale.

Materiale të nevojshme: Fleta e punës “Kultura” për çdo nxënë.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Në tabelë apo në një tabak të madh letre shkruhen thëniet e mëposhtme:
 - Asnjë nuk është krejtësisht si unë.
 - Unë kam plot gjëra të përbashkëta me pjesëtarët e familjes time dhe të komunitetit.
 - Të gjithë në botë kanë nevojë për disa nga gjërat që dua edhe unë.

I kërkohet nxënësve të shkëmbejnë ide që mbështesin këto thënie. Duhet nënvizuar që njerëzit në grupe të ndryshme shpesh i shikojnë njerëzit e grupeve të tjera shoqërore si të “ndryshëm”. I kërkohet nxënësve të përshkruajnë disa nga këto ndryshime. Pse njerëzit në një grup shoqëror mund të sillen ndryshe nga njerëzit në një grup tjetër? Kur flitet për sjelljet dhe bindjet që kanë një grup i caktuar njerëzish, i tregohet nxënësve që po flitet për kulturën ose më saktë brenda një grupi të madh etnik flitet për “minikultura”.

2. Nxënësve i kërkohet që të plotësojnë fletën e punës në mënyrë që të bëhet e mundur identifikimi i aspekteve të kulturave apo minikulturave të tyre. Nxënësit duhet t'i përgjigjen çdo pyetjeje me një fjali apo frazë. Ata duhet t'i rendisin pyetjet (çështjet) sipas rëndësisë që mendojnë se ato kanë në kulturën e tyre.
3. Pasi secili ka plotësuar fletën e punës, nxënësve u kërkohet të mblidhet në grup (5-6 veta) dhe t'i bëjnë të ditur njëri tjetrit gjërat që kanë shkruar në fletën e punës së tyre. Po kështu nxënësve në grup i kërkohet të krahasojnë dhe të dallojnë aspekte të ndryshme të kulturave të tyre individuale.

FLETË PUNE

“KULTURA”

Shkruani një fjali apo shprehje për çdo pyetje. Pastaj i renditni pyetjet nga 1 deri në 8 sipas vlerës që ka çështje në kulturën tuaj.

- A. Çfarë gjuhe/dialekti flisni ju? _____
- B. Çfarë feje praktikon familja juaj? _____
- C. Çfarë muzike/ këngësh këndohen në vendin tuaj të origjinës? _____

- D. Çfarë kërcimesh dini si të vendit tuaj, nga kenë origjinën? _____
- E. Cili është gatimi më karakteristik (që e dallon) për kuzhinën e familjes tuaj? _____
- F. Çfarë vishni në raste të veçanta, siç mund të jenë dasmat? _____
- G. Do ta përshkruanit familjen tuaj si “bërthamë” (prindërit dhe fëmijët) apo “të shtrirë” (me gjyshët, halla, xhaja apo kushërinj të afërt)? _____
- H. Emri i kulturës time është _____

Qëllimi i edukimit joformal për përfshirjen sa më aktive e nxënësve të marginalizuar si dhe rritjen e efektivitetit të të nxënësve do të arrihet kur nxënësit përshihen në veprimtari që i bëjnë ata të kuptojnë se shkolla i mirëpret dhe se bën të gjithë përpjekjet që ata të jenë plotësisht të motivuar për të marrë pjesë. Kjo të çon në qartësimin e faktit që natyra e veprimtarive duhet të jetë jo vetëm përfshirëse por edhe të prekë probleme që ata i shqetësojnë çdo ditë.

Më pëlqen shkolla ime

Qëllimi: Të ndihmohen nxënësit të reflektojnë mbi atë se sa përfshirëse është shkolla e tyre dhe se si shkolla në përgjithësi mund të bëhet më përfshirëse.

Mjete të nevojshme: letër dhe stilolaps për çdo nxënë.

Zhvillimi i veprimtarisë

Në fillim të veprimtarisë nxënësit janë të ulur në vendet e tyre dhe mbajnë përpara një fletë letre e një stilolaps. Mësuesi iu shpjegon paraprakisht qartë për mënyrën se si do të zhvillohet veprimtaria dhe i flet për teknikën e vizualizimit dhe për atë se si do të veprojnë ata. (Vizualizimi është teknikë që përdoret për të rritur përfshirjen emocionale të nxënësve dhe për të ngritur motivimin e tyre. Zakonisht ajo realizohet duke i kërkuar nxënësve të përfytyrojnë gjërat si ata do t'i donin apo përfytyrojnë)

1. Mësuesi sigurohet që të gjithë nxënësit janë në vendet e tyre të ulur. Ai iu kërkon atyre të mbyllin sytë dhe të qetësohen: “Mbyllni sytë dhe rriini të qetë. Dëgjoni frymëmarrjen tuaj... Dëgjoni zhurmat rreth jush dhe jashtë klasës. Dëgjojeni ato dhe më pas mos u vini veshin atyre ... etj. Imagjinoni që po vini në shkollë në ditën e parë të vitit shkollor dhe shkolla është tamam si ajo që ju do ta dëshironit. Çfarë vini re kur arrini në hyrje të shkollës? Kush është aty me ju? Ç’loj mirëseardhje merrni nga mësuesit dhe drejtori i shkollës? Etj. Si është klasa juaj? (Pyetje të tjera rreth aspekteve të tjera të klasës) Si sillet mësuesi me ju? Etj, etj”
2. Tani mësuesit kthehen gradualisht në fillim të veprimtarisë: “dëgjoni frymëmarrjen tuaj apo zhurmat rreth e rrotull. Hapni sytë dhe vazhdoni të rriini i qetë” Më pas mësuesi iu kërkon që ashtu të qetë dhe pa komunikuar me të tjerët të shkruajnë një fjalë, fjali apo vizatim ndjesinë që iu krijua gjatë veprimtarisë. Pas kësaj i kërkohej të shkruajnë gjërat kryesore që ata përfytyruan gjatë vizualizimit.
3. Nxënësit në çift ose në grupe diskutojnë me njëri tjetrin për gjërat e shkruara. Në fund të diskutimit ata bien dakord për tre aspektet më kryesore dhe të rëndësishme të shkollës ideale për ta. Këto përfundime i prezantojnë para klasës.

I.3 KURRIKULA NË EDUKIMIN JOFORMAL



Edukimi në klasat joformale shtron nevojën për:

- Një **kurrikul cilësore** dhe të përshtatshme
- Një **vlerësim** që bazohet në arritjet e nxënësve, i cili mund të përdoret për të mbështetur dhe inkurajuar të gjithë fëmijët.

Efektiviteti i mësimdhënies dhe i të nxënit në klasat joformale shtron nevojën e një kurrikule cilësore dhe të përshtatshme për nxënësit në këto klasa. Kjo do të thotë një kurrikul shumë afër me nevojat e këtyre nxënësve, jo e bazuar në gjininë, motivuese dhe lehtësisht e praktikueshme për të gjithë.

Disa elementë të rëndësishëm të kurrikulës që do ta bënin atë më efektive dhe më të përshtatshme për klasat joformale janë:

- **Qëllime dhe objektiva të gjerë**, të përcaktuar për të gjithë nxënësit, që përfshijnë njohuritë, aftësitë dhe vlerat që duhet të fitohen.
- **Një strukturë fleksibël** që i përgjigjet diversitetit të nxënësve dhe problematikave dhe çështjeve që trajton.
- **Përmbajtje** që siguron njohuri, aftësi dhe vlera lidhur me çështje jo vetëm të lëndëve që zhvillohen në shkollë por edhe më çështje që kanë të bëjnë me **probleme sociale** aktuale për nxënësit dhe shoqërinë sot.
- **Trajtime** dhe veprimtari që hapin hapësira për të dalë jashtë kornizës së klasës e shkollës me problematikat që trajtohen.

Nga ato që thuhet më lart duket qartë që mësuesit që mundësojnë edukimin joformal duhet të planifikojnë të zhvillojnë veprimtari lidhur me kurrikulat lëndore që këta fëmijë zhvillojnë në edukimin formal. Por, duhet bërë kujdes që trajtimi i kurrikulës të përcillet përmes veprimtarive që përfshijnë nxënësit në mënyrë aktive dhe që i trajtojnë njohuritë lëndore përtej kornizës së ngushtë të asaj lënde.

Veprimtaritë **matematike apo të shkencave të tjera ekzakte**, në kontekste të ndryshme, u krijojnë nxënësve hapësira për të shpjeguar dukuritë e botës përreth. Përvetësimi i tyre krijon mundësi për thithjen dhe përpunimin e informacioneve të dukurive të ndryshme të natyrës. Prandaj është shumë e rëndësishme që mësuesi të kombinojë dhënien e njohurive të reja me probleme nga jeta e përditshme, ku të kërkohet pjesëmarrja aktive e të gjithë nxënësve. Rekomandojmë trajtimin e problematikave të tilla si:

- “matematika në shtëpi”,
- “matematika në udhëtim”,
- “matematika në treg”, etj
- si dhe të dhëna statistikore nga jeta e përditshme në shkollë e familje të jenë të pranishme në orët e mësimin.

Kjo e bën mësimin më interesant dhe u forcon nxënësve besimin në vetvete. Në zhvillimin e aftësive të tilla si klasifikimi, matja, krahasimi, konkluzioni etj, mësuesi duhet të trajtojë shumëllojshmëri stimuluesh dhe shembujsh duke përdorur materiale konkrete. Në prezantimin e koncepteve këshillohet që mësuesi të përdorë materiale konkrete që janë familjare për fëmijën, për të mbajtur e përqendruar vëmendjen e fëmijëve në konceptet kryesore.

Lënda: Matematikë**Thyesat*****Koha:** 45 minuta**Objektivat:** Në fund të kësaj veprimtarie nxënësit do të jenë të aftë të:

- Qartësojnë më tej kuptimin e thyesës;
- Përforcojnë shprehitë e krahasimit të dy thyesave;
- Argumentojnë vendimet e tyre;
- Zhvillojnë shprehitë e komunikimit.

Materiale të nevojshme: 8 skeda për çdo grup me 4 veta. Në secilën skedë është shkruar një nga numrat thyesorë: $1/2$; $1/3$; $1/4$; $2/3$; $3/4$; $3/2$; $4/3$; $5/4$.**Zhvillimi i veprimtarisë**

1. Katër nxënësit e një grupi dallohen nga njëri tjetri si “nxënësi 1”, “nxënësi 2”, “nxënësi 3” dhe “nxënësi 4”. Tetë skedat përzihen nga nxënësi 1. Ai ndan nga një skedë për secilin nxënës të grupit. Nxënësit pasi i shohin skedat vendosin se kush e ka skedën me numrin thyesor më të madh. Ai nxënës fiton një pikë.
2. Loja vazhdon në të njëjtën mënyrë, por tashmë me radhë nxënësi 2 bën përzierjen dhe shpërndarjen e skedave e më pas nxënësi 3 dhe 4. Në fund shpallet fituesi i lojës në grup.
3. Mësuesi gjatë gjithë lojës ndihmon nxënësit të bëjnë krahasimin e thyesave, duke lehtësuar ato që nuk arrijnë ta bëjnë atë. Në fund mësuesi sharron dhe nxjerr në pah mënyrat e ndryshme të krahasimit të thyesave.

Siç u vu re nga shembulli i mësipërm, në klasat joformale mund të realizohen mirë dhe objektiva të lëndës por gjithmonë duke i thjeshtuar ato dhe duke i realizuar përmes veprimtarive ndërvepruese, argëtuese dhe tërheqëse për nxënësit. Mirë është të ndalohet te ato njohuri që janë kyç për formimin e nxënësit në një lëndë të caktuar.

Studimi i *letërsisë, gjuhës, historisë, gjeografisë dhe edukatës* si fusha të rëndësishme e kurrikulit shkollor ofron një fuqi të madhe për zhvillimin personal të nxënësve, përfshirë këtu njohjen, sjelljet, vështrimin mbi botën, duke i parë ato në perspektiva të ndryshme, në përshtatje me një traditë kulturore të pasur dhe dinamike dhe të një të kuptuari edhe më të gjallë të proceseve të tilla që lidhen me fenomenet shqetësuese të shoqërisë sonë.

Përmes historive, ngjarjeve, pjesëve të leximit, studimit gjeografik etj, tregohet kujdes ndaj vlerave kulturore të traditës. Mbi këto kontekste fëmijët bëhen krijues të marrëdhënieve të reja humane dhe vlerave të reja njerëzore.

Më poshtë vijohet me shembuj të tjerë nga kurrikulat lëndore.

* Marrë nga “Manual i mësuesit për edukimin global”, ISP Tiranë 2000

Lënda: Gjeografi

Vështrim i përgjithshëm mbi pozitën gjeografike dhe relievin e Afrikës

Objektivat: Në fund të këtij aktiviteti nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë në hartë pozitën gjeografike të kontinentit të Afrikës;
- të përmendin disa nga veçoritë kryesore të relievit të Afrikës;
- të evidentojnë disa nga problemet e mjedisit sot në këtë kontinent

Mjete të nevojshme: Hartë fizike e Afrikës për gjithë klasën, hartë fizike ose politike për secilin nxënësi, hartë e Afrikës e prerë përgjatë vijës bregdetare për secilin grup, letër formati A4 për çdo nxënësi, letër formati për çdo grup.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Si fillim bëhet një aktivitet hyrës. Nxënësve iu jepet 3 minuta kohë që ë një copë etër të shkruajë “gjërat që ato do të donin të vizitonin në kontinentin e Afrikës”. Nxënësit këshillohen të shkruajnë me shkronja të mëdha në letrën A4 që i është dhënë nga mësuesja. Pas kësaj kohe secili nxënësi fillon të ecë nëpër klasë, duke mbajtur letrën të ngritur para gjoksit të et, dhe bisedon me shokët për ato që kanë shkruar. Nxënësit inkurajohen që të flasin dhe të shkëmbejnë preferencat e tyre me njëri tjetrin gjatë kohës së përcaktuar.
2. Ndahen nxënësit në grupe pune. Secilit grup i jepet një hartë e Afrikës e prerë përgjatë vijës së saj bregdetare, të cilën nxënësit do ta ngjisin në një letër formati. Më pas nxënësit e çdo grupi do të përcaktojnë emrat e deteve dhe të oqeanëve që e lagin kontinentin, ngushticat, gjiret si dhe ekuatorin. Këtë grupet mund ta realizojnë duke u konsultuar me hartën e vënë para klasës ose atlasit që ata disponojnë. Në mbarim të kohës së përcaktuar punët prezantohen nga një përfaqësues i grupit. Mësuesi bën plotësimet e nevojshme.
3. Pasi mësuesi iu flet nxënësve për veçoritë dalluese të relievit të Afrikës hap me nxënësit diskutimin mbi ato që ata dinë për rrallimin e disa lloje kafshësh dhe bimësh në këtë kontinent. Pse ndodh kjo? Ç’dinë ata për parqet e mëdha natyrore që ka në këtë kontinent? Përse shërbejnë ato? Etj.

Sbënim: Aktiviteti hyrës i jep mundësi nxënësve të japin informacionin personal që ato kanë dhe të shfaqin interesat e tyre. T’i lejon nxënësit të shkruajnë atë që iu pëlqen dhe të flasin me shokët e tyre për to, do të thotë të kultivosh tek ato sigurinë në vet-vete.

Mësuesi duke përdorur analogjinë, mund të realizojë këtë veprimtari dhe në temat e pozitës gjeografike dhe të relievit të kontinenteve të tjerë

Lënda: Gjuhë

Ligjërata e drejtë dhe e zhdrejtë*

Objektivat: Në fund të veprimtarisë nxënësi të jetë i aftë të:

- Përvetësojë rregulla pikësimi, që duhen përdorur në ligjërata të drejtë dhe të zhdrejtë;
- Komunikojë me mirëkuptim me të tjerët;
- Përdorë si duhet rregullat e pikësimit

Mjete të nevojshme: fletë pune për çdo nxënës përgatitur nga mësuesi, letër, lapsa.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Mësuesi ka përgatitur dy fletë pune për nxënësit si më poshtë: në njërin ka shkruar fjali në ligjërata të drejtë dhe është bosh pjesa në ligjërata të zhdrejtë ndërsa në tjetrën fjali në ligjërata zhdrejtë dhe bosh kolonën tjetër.

Ligjërata e drejtë	Ligjërata e zhdrejtë

Çdo nxënës punon në fletën e tij të punës duke i kthyer fjalitë në ligjërata të drejtë ose të zhdrejtë sipas fletës së punës që ka përpara.

2. Pasi plotëson fletën e tij, nxënësi e këmben atë me shokun pranë, i cili nuk e ka pasur fletën të njëjtë me të. Ata korrigjojnë shenjat e pikësimit në rastin kur nuk janë përdorur drejt dhe, më pas, komunikojnë me njëri tjetrin, derisa bien dakord për variantin përfundimtar të punimeve të tyre.
3. Në fund secili çift nxënësish tregon punën e bërë para klasës. Mësuesi korrigjon dhe këshillon nxënësit për shenjat e pikësimit

I.4 OBJEKTIVAT KROSKURRIKULARË DHE EKSTRAKURRIKULARE NË EDUKIMIN JOFORMAL

Kurrikulat lëndore që trajtohen në klasat joformale mund të bëhen më efektive dhe më tërheqëse për nxënësit kur ato kanë objektiva më të gjerë se thjesht lëndore. Kjo do të thotë se do të ishte shumë e dobishme që përmes lëndëve të realizoheshin dhe objektiva që i kapërcejnë kufijtë lëndore dhe që trajtojnë çështje dhe problematika që lidhen ngushte me fenomenet sociale nga të cilat janë ndikuar jetët e nxënësve që vijnë në këto klasa. Këto çështje mund të trajtohen përmes realizimit të objektivave kroskurrikulare dhe ekstrakurrikulare.

Objektivat kroskurrikulare përcillen në mësim përmes një veprimtarie që gërshetohet brenda një ore mësimore, e cila ka lidhje me temën dhe konceptet që trajtohen, por dhe që ofron njohuri të tjera, plotësuese në atë drejtim, mbi të cilin është përqendruar të mësuarit

Fushat kroskurrikulare rreth së cilave mund të arrihen objektiva të caktuara janë të shumta, gjë që do të thotë se dhe veprimtaritë që mund të planifikohen janë të shumta.

* Marrë nga "Manuali i mësuesit për edukimin global" ISP, Tiranë 2000.

Disa nga këto fusha të rëndësishme dhe aktuale në shoqërinë tonë janë:

- Edukimi me të drejtat e njeriut
- Puna e fëmijëve
- Trafikimi i qenieve njerëzore
- Edukimi mjedisor
- Edukimi shëndetësor
- Edukimi global
- Barazia gjinore
- Aftësimi për jetën
- Edukimi ndër kulturor
- Zgjidhja e konflikteve dhe toleranca
- Edukimi për demokraci
- Edukimi për paqe dhe çarmatim
- Njohja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara
- Edukimi rrugor
- Edukimi ekonomik
- Etj

Lënda : Histori

Feudalët dhe bujkrobërit

Objektivat: Në fund të këtij aktiviteti nxënësi duhet të jetë i aftë :

- Duke krahasuar bujkrobin dhe skllavin, të nxjerrë ndryshimet midis tyre dhe të drejtat që i mohoheshin.
- Duke krahasuar rendin fisnor, skllavopronar dhe atë feudal, të nxjerrin zhvillimet e shoqërisë.

Mjete të nevojshme: Tabak letre, ngjyra, lapsa, letër format.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Mësuesi paraqet para klasës planin e një bashkësie fisnore dhe në bashkëbisedim me to nxjerr veçoritë e mënyrës së jetesës në rendin fisnor. Pasi u shpjegon nxënësve për feudin dhe çifligun, u kërkon atyre që së bashku të vizatojnë planin e çifligut.
2. Mësuesi kërkon prej nxënësve të thonë se si ndodhi procesi i bujkrobërimit të fshatarëve (bujqve) të lirë. Më pas u flet nxënësve për detyrimet e bujkrobit. Pas kësaj kërkon prej nxënësve të nxjerrin ndryshimet midis skllavit dhe bujkrobit.
3. Nxënësit, për pak minuta, lexojnë materialet plotësuese (leximet) në tekst. Pas kësaj e ndan klasën në grupe (5-6 nxënës secili grup). Secili grup përgatitet si më poshtë :
 - a) Dialog midis një skllavi dhe bujkrobit;
 - b) dialog midis një feudali dhe bujkrobit;
 - c) vizatoni një kështjellë feudale;
 - d) vizatoni një veshje feudale (kalorësi);
 - e) vizatoni një veshje fshatari (bujkrobit).
4. Çdo grup paraqet punën e tij. Pasi grupi i dytë paraqet dialogun feudal-bujkrob zhvillohet diskutimi :
 - Çfarë ndjen bujkrobit kur feudali nuk e trajton mirë?
 - Çfarë të drejtash i mohohen atij?

Shënim: Dy grupet e fundit (d,e) vizatimet mund t'i bëjnë në tabakë letre, të presin me gërshtë dhe të bëjnë një veshje të një kalorësi në mesjetë.

Objektivat ekstrakurrikulare janë të gjitha llojet e objektivave që përmbushen jashtë procesit të zhvillimit të kurrikulës të pasqyruar përmes lëndëve, për të realizuar synimet e një edukimi tjetër, por që çojnë në përmbushjen e objektivave dhe kërkesat e kurrikulës në përgjithësi. Pra këta objektiva përcillen përmes veprimtarive që nuk kanë të bëjnë me lëndë të caktuara por që mund të lidhen shumë mirë me ato dhe mund t’iu shërbejnë atyre.

Të drejtat tona

Qëllimi: Të inkurajohen nxënësit që të shqyrtojnë të drejtat e tyre duke përcaktuar dhe prioritetet e tyre.

Objektivat: Në fund të kësaj veprimtarie nxënësit do të jenë të aftë të:

- njohin të drejtat e pasqyruara në Konventën e të Drejtave të Fëmijës;
- vendosin prioritetet për disa të drejta;
- kuptojnë aftësitë e nevojshme për vendosjen e konsensusit.

Materiale të nevojshme: Kopje e fletës së punës 1 “Kartat e të drejtave të fëmijës” për çdo çift nxënësish, tabak letre për çdo grup, fleta e punës 2 “Renditja në formën e diamantit” për çdo grup.

Zhvillimi i veprimtarisë


1. I kërkohet nxënësve të ndahen në çifte. Secilit çift i jepet një set i kartave të të drejtave të fëmijës. Seti përmban nëntë kartat e prera nga fleta e punës 1. Çiftit i kërkohet të rendisë të drejtat sipas rëndësisë që ata kanë. Renditja do të bëhet sipas formës së diamantit të treguar në fletën e punës 2, që do të thotë: një kartë, që është më e rëndësishmja, në majë, dy të tjerat në nivelin tjetër më poshtë, tre në të tretin, dy në të katërtin dhe në nivelin e pestë karta me të drejtën “më pak të rëndësishme”.
2. Pasi nxënësit të kenë renditur kartat e të drejtave, i kërkoni çifteve të bashkohen me dy çifte të tjerë duke formuar një grup me gjashtë veta. I jepen nxënësve 10 minuta kohë për të rënë dakort në grup së bashku për një renditje përfundimtare të të drejtave.
3. Organizoni një diskutim me gjithë klasën mbi veprimtarinë. A ishin në gjendje nxënësit për të arritur në konsensus? Cilat vendime qenë të vështira? Pse është e vështirë të rendisësh së drejtat? Cila do të ishte pasoja në qoftë se një nga të drejtat do të hiqej plotësisht? Pse i është dhënë i njëjti status të drejtave në Konventë? Në ç’mënyrë këto të drejta janë të padukshme dhe të ndërlydhura?
Kërkoni më pas që nxënësit si klasë të përcaktojnë renditjen e të drejtave sipas rëndësisë që ata ndiejnë që i kushton qeveria dhe komuniteti i tyre:
 - Pse mendoni që qeveria i kushton më shumë rëndësi disa të drejtave?
 - Cilat të drejta duhen përmirësuar në komunitetin tuaj në mënyrë që të ndërtohet një kulturë paqeje?
 - Cilat të drejta mund të mungojnë në konventë, të cilat do të ndihmojnë në krijimin e një kulture paqeje?

KARTAT E TË DREJTAVE TË FËMIJËS

FLETË PUNE 1

<p>MOSDISKRIMINIMI Të gjithë të drejtat i drejtohen të gjithë fëmijëve pa përjashtim. Është detyrim i shteteve të mbrojnë fëmijët nga çdo lloj forme diskriminimi dhe të ndërmarren veprime pozitive për të garantuar të drejtat e tyre.</p>	<p>STANDARTI I JETESËS Çdo fëmijë ka të drejtën e një standarti jetese të përshtatshëm për zhvillimin e tij/saj fizik, mendor, shpirtëror, moral dhe shoqëror. Prindërit kanë përgjegjësinë kryesore për të siguruar që fëmija ka një standard jetese të përshtatshëm. Detyra e shtetit është që të sigurojë që kjo përgjegjësi mund të përmbushet.</p>	<p>EMRI DHE KOMBËSIA Fëmija ka të drejtën e një emri që në lindje. Gjithashtu fëmija ka të drejtë të ketë një kombësi dhe të njohë prindërit e tij/saj dhe të gëzojë kujdesin e tyre aq sa të jetë e mundur.</p>
<p>SHËNDETI DHE SHËRBIMI SHËNDETËSOR Fëmija ka të drejtën e standartit më të lartë të shëndetit dhe kujdesit shëndetësor. Shtetet duhet të vënë theks të veçantë mbi kujdesin shëndetësor primar dhe parandalues, edukimin shëndetësor dhe uljen e vdekshmërisë foshnjore. Ata duhet të inkurajojnë bashkëpunimin ndërkom-bëtar në lidhje me këtë.</p>	<p>QËLLIMET E EDUKIMIT Edukimi duhet të synojë në zhvillimin e personalitetit të fëmijës, talenteve dhe aftësive mendore e fizike. Edukimi duhet të përgatitë fëmijën për një jetë aktive si i rritur në një shoqëri të lirë dhe të nxisë respektin për prindërit e tyre, identitetin kulturor të tij/saj, gjuhën, vlerat dhe për kulturën e vlerat e të tjerëve.</p>	<p>ADMINISTRIMI I DREJTËSISË RINORE Një fëmijë në konflikt me ligjin ka të drejtën e trajtimit i cili siguron ndjenjën e dinjitetit dhe vlerës, merr në konsideratë moshën e fëmijës dhe siguron riintegrimin e tij/saj në shoqëri.</p>
<p>KUJDESI PËR REHABILITIMIN Shteti ka një detyrim të sigurojë që fëmijët viktimë të konflikteve të armatosura, torturës, shfrytëzimit, keqtrajtitit ose braktisjes marrin trajtimin e duhur për përmirësim dhe riintegrim social.</p>	<p>PUNA E FËMIJËVE Fëmija ka të drejtën për të qenë i mbrojtur nga puna që dëmton shëndetin, edukimin ose zhvillimin e tij/saj. Shteti duhet të vendosë moshën minimale për punësim dhe të rregullojë kushtet e punës.</p>	<p>KOHA E LIRË, DËFRIMI DHE AKTIVITETET KULTURORE Fëmija ka të drejtën e kohës së lirë, lojës dhe pjesëmarrjes në aktivitetet kulturore dhe artistike.</p>

Renditja në formën e diamantit



Cili është statusi i veprimtarive kurrikulare në edukimin joformal?

- **Objektivat** që përcaktohen në planifikimin e mësimit dhe të veprimtarive **nuk janë të detyrueshme** të zbatohen siç ndodh me objektivat lëndorë. Kjo do të thotë se mësuesi mund të planifikojë ato objektiva që ai i mendon më të përshtatshme për nxënësit. Ai gjithmonë bën kujdes që të përcaktojë objektiva që lehtësojnë dhe përmirësojnë të nxënësit e nxënësve në mësimin formal.
- Veprimtaritë **nuk kanë në dispozicion hapësirë kohore**. Kjo do të thotë se përm-bushja e një objektivi të caktuar mund të shtrihet në më shumë se një orë mësimore. Kjo do të bëjë që nxënësit të përvetësojnë më mirë dhe të aftësohen lidhur me çështjet që trajton veprimtaria.
- Aplikimi i veprimtarive në edukimin joformal bëhet në kushtet kur **mungon tradita**. Edukimi joformal në vendin tonë është në hapat e parë. Kjo bën të mundur që mësuesit duhet të përpiqen dhe të aftësohen për të qenë efektiv në mësimdhënie në klasat joformale.
- Veprimtaritë kurrikulare në këtë rast shihen si pjesë e **lirisë akademike të mësuesit**. Kjo duket në vetëvendosjen e mësuesit lidhur me tematikat, objektivat dhe veprimtaritë që zhvillohen në klasë.
- Veprimtaritë që zhvillohen shpesh **nuk janë të lidhur me një nivel të caktuar shkollimi**. Ndodh shpesh që nxënësit pavarësisht nga mosha marrin pjesë në të njëjtën veprimtari dhe realizojnë të njëjtët objektiva.
- Për arritjet e nxënësve në këto veprimtari **nuk ka vlerësim me notë**. Kjo do të thotë që ky është një nga rastet e vetme kur nxënësi është i çliruar nga presioni i notës. Kjo e bën mësimin më të "rehatshëm" për nxënësin dhe mësuesit.
- Aplikimi i veprimtarive kurrikulare në edukimin joformal shihet si mundësi për të **afruar disiplinat e mirëfillta shkencore me problemet bashkëkohore**. Kjo do të thotë se mësuesit përpiqen dhe disiplinat më akademike dhe "të vështira" për nxënësit të përcillen lehtë te ata përmes gërshetimit të njohurive që ata përmbajnë me problemet sociale të prekshme nga fëmijët.



Si përfundim mund të themi se:

- Aplikimi i objektivave kros dhe ekstrakurrikularë shikohen tashmë jo si një zgjedhje por, si një zgjidhje për të kapërcyer problemet sociale dhe të integritetit në shkollë të fëmijëve që punojnë, që kanë qenë të trafikuar apo që janë në rrezik për të punuar.
- Formulimi i objektivave kros & ekstrakurrikularë është tashmë një detyrë e mësuesve që punojnë në klasat joformale
- Rëndësia e këtyre objektivave është jo vetëm për faktin se e afrojnë nxënësin me një sistem njohurish dhe shprehish që nuk ja ofron asnjë lëndë e mirëfilltë akademike, por se i jep nxënësit shprehitë për të menaxhuar raportet e tij në grup dhe me institucionet e tjera sociale

Veprimtaria e mëposhtme trajton konceptin e përkatësisë gjinore dhe diskriminimit gjinor në mjediset tona shoqërore në përgjithësi dhe shkollore në veçanti: ky problem është i rëndësishëm të trajtohet me fëmijët që kanë qenë të trafikuar apo ata që punojnë.

Historia e Kristit*

Qëllimi: Shqyrtimi i paragjyqimeve që bëhen zakonisht mbi njerëzit bazuar në përkatësinë gjinore dhe etnitetin e tyre.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Ndajini nxënësit në dy grupe mikse nga pikëpamja gjinore. Shpërndajini grupit A kopje të “Historisë së Kristit” (D)-djalë dhe grupit B kopje të “Historisë së Kristit” (V)-vajzë.

Bëj kujdes!: Grupet nuk duhet të kuptojnë që po ju jepen histori të ndryshme. Përderisa emrat e karaktereve janë homofonë, mësuesi mund të thotë që secili do të lexojë “Historinë e Kristit” pa komentuar faktin që në njërin rast personazhi është vajzë dhe në tjetrin djalë.

Grupi A – Historia e Kristit (D)

Kristi është një djalë 12 vjeçar. Ai është ndër djemtë më të qetë në klasën e tij. Kristi është pak i ndrojtur kur flet para të gjithë klasës por atij i pëlqen të mësojë në grupe të vogla. Ai ka shumë shokë e shoqe. Kristi është shumë i mirë në gjuhë e lexim por ka probleme në matematikë.

Pas mësimit, Kristit i pëlqen të shohë televizor. Ai lexon shumë, sidomos kuriozitete dhe histori për kafshët. Atij i pëlqen të luajë në park me shokët dhe ndonjëherë, ai kujdeset për vëllain e tij. Ai lan dhe enët ndonjëherë kur prindërit ia kërkojnë.

Grupi B – Historia e Kristit (V)

Kristi është një vajzë 12 vjeçare. Ajo është ndër vajzat më të qeta në klasën e saj. Kristi është pak e ndrojtur kur flet para të gjithë klasës por asaj i pëlqen të mësojë në grupe të vogla. Ajo ka shumë shokë e shoqe. Kristi është shumë e mirë në gjuhë e lexim por ka probleme në matematikë.

Pas mësimit, Kristit i pëlqen të shohë televizor. Ajo lexon shumë, sidomos kuriozitete dhe histori për kafshët. Asaj i pëlqen të luajë në park me shokët dhe ndonjëherë, ajo kujdeset për vëllain e saj. Ajo lan dhe enët ndonjëherë kur prindërit ia kërkojnë.

2. Hapi i dytë

Drejtoju të dy grupeve të njëjtat pyetje por gjithmonë duke pasur parasysh faktin që në njërin rast personazhi kryesor është djalë dhe në tjetrin vajzë.

Ç’gjë ju bën më shumë përshtypje te Kristi(V)/(D)?

- Që është i/e ndrojtur
- Që ka shumë shokë e shoqe
- Që nuk është i/e mirë në matematikë
- Që i pëlqen të luajë në park me shokët
- Që kujdeset për vëllain
- Që lan enët

Ju përzgjedhët disa prej tyre. Jepni arsyet tuaja, pse bëtë një zgjedhje të tillë.

A lidhet kjo me faktin që Kristi është djalë/vajzë?

* Marrë nga “Paketa burimore mbi përkatësinë gjinore”, QAGJJZH, Tiranë 2006.

Pjesa II.

Mësimdhënia dhe të nxënit efektiv në edukimin joformal



Ju kujtojmë se:

- Mësues efektiv është ai që i respekton të gjithë nxënësit, pranon ndryshimet e tyre, i dëgjon dhe i ndihmon të bëhen zgjidhës të probleme.
- Fëmijët kanë stile të ndryshme të të nxëni dhe kjo kërkon mbështetje nga ana e mësuesit.
- Trajtimi i mësimin me në qendër nxënësin është një mësimdhënie aktive, interaktive e reflektive dhe realizon pjesëmarrjen e nxënësve, udhëheqjen dhe mbështetjen nga mësuesi.
- Menaxhimi i klasës përfshin aspektin social dhe është thelbësor në promovimin e eksperiencave pozitive për nxënësit.
- Mësuesi ka një rol model kryesor dhe është personi kyç i aftë për të mbështetur motivimin pozitiv dhe të nxënit e nxënësve.

II.1 MËSUESI DHE MËSIMDHËNIA EFEKTIVE:

Kur flasim për karakteristikat e një mësuesi “efektiv”, i referohemi përgjigjeve të pyetjeve të mëposhtme:

- Si sillet ai/ajo?
- Çfarë di ai/ajo?
- Si i trajton nxënësit?
- Çfarë kualifikimi apo mbështetje ka ai/ajo?
- Kujt i ngjan ai/ajo?
- Si e di ai/ajo që është një mësues i mirë?

Mësuesi efektiv është ai i cili me mënyrën e veprimit dhe qëndrimin e tij respekton të gjithë nxënësit, i dëgjon ato dhe i ndihmon të bëhen zgjidhës të problemeve si dhe të ndajnë ide të mira mes tyre. “Mënyra se si jepni mësim është po aq e rëndësishme sa çfarë ju jepni mësim”. Qëndrimi dhe sjellja e mësuesit është po aq e rëndësishme sa dhe aktivitetet që ai/ajo zhvillon me fëmijët. Një mësues efektiv është gjithashtu ai që di dhe kupton disa parime bazë mbi atë se si fëmija nxë dhe gjithashtu di të përdorë trajtime të ndryshme në mësimdhënie për të ndihmuar të gjithë fëmijët.



5 kriteret bazë për mësimdhënien efektive

1. Planifikon dhe paraqet materialin në një linjë logjike;
2. E vendos mësimin në nivelin e nxënësve dhe merr parasysh dallimet individuale të tyre;
3. Krijon mundësi për të praktikuar dhe aplikuar atë që është mësuar;
4. I mundëson nxënësit të dinë se çfarë pritet nga ata;
5. monitoron dhe vlerëson arritjet e nxënësve në një mënyrë që i krijon mundësi të mësojnë nga gabimet.

Një mësues efektiv është ai që:

- është i qartë në dhënien e instruksioneve;
- është entuziast dhe i orientuar nga detyrat;
- shkruan qartë;
- përdor shumëllojshmëri trajtimesh dhe strategjish;
- i krijon hapësira nxënësve të nxënë vetë dhe inkurajon suksesin;
- bën komente dhe sugjerime konstruktive;
- vlerëson kontributin e të gjithë nxënësve;
- respekton nxënësit; dhe
- tregon kujdes, ndershmëri dhe bashkëpunim.

Një mësues efektiv mëson dhe inkurajon nxënësit të zhvillojnë aftësitë e të menduarit dhe zgjidhjes së problemit, të përfshihen më shumë dhe motivohen në procesin e të nxënit.

Një mësues efektiv përpiket të mësojë nxënësit se si të mendojnë, si të nxënë dhe si të kontrollojnë procesin e tyre të të nxënit. E gjithë kjo arrihet përmes të pyeturit dhe përdorimit të llojeve të ndryshme të pyetjeve sipas situatës që krijohet dhe objektivit mësimor

Lënda: Gjeografi

Bregdeti i Shqipërisë

Qëllimi: Identifikimi i njohurive që kanë nxënësit përmes përdorimit të pyetjeve

Në shpjegimin e temës “Bregdeti i Shqipërisë” mësuesi fillimisht drejton pyetje për të nxitur kujtesën e nxënësve.

Mësuesi: Unë mendoj se shumë nga ju i kaloni pushimet verore në bregdet. Mendoni dhe tregoni disa nga plazhët ku keni qenë? Paузë

Nxënësi 1: Unë kam parë plazhin e Durrësit dhe Divjakës.

Nxënësi 2: ...

Nxënësi 3: ...

Nxënësi 4: Unë kam qenë në Pogradec.

Mësuesi: Shumë mirë. Ju Ilir keni pushuar në plazhin e Pogradecit. Pa mendoju pak, cili det ndodhet aty?

Nxënësi: Ah, po. Aty është liqeni i Ohrit. Harrova që po flasim për bregdetin.

Mësuesi: Mirë. Tani Arben mund të na tregosh si ishte plazhi i Divjakës?

Nxënësi: Kishte shumë rërë, deti nuk ishte shumë i thellë. Kishte dhe pyll.

Mësuesi: Po plazhi i Dhërmiut Ilda, si ishte?

Nxënësi: Në borsh nuk kishte rërë por guralecë dhe shkëmbinj. Aty ku rrinim në plazhi ishte i vogël dhe deti ishte i thellë qysh në fillim.

Mësuesi vazhdon me trajtimin e informacionit të ri duke dhënë veçoritë e dy bregdeteve dhe format që ndeshen në to. Më pas ai u drejton pyetje nxënësve për të nxitur të kuptuarit dhe imagjinatën e tyre.

Mësuesi: Tani që u njohëm me veçoritë e dy bregdeteve, secili të mendojë të japë ndryshimin mes tyre.

Nxënësi: Bregdeti Adriatik është i ulët me rërë, ndërsa ai Jon është i lartë e shkëmbor.

Mësuesi: Po, tjetër? Pauzë Anila?

Nxënësi: Bregdeti i Adriatikut, në pjesën dërrmuese të tij, përparon drejt detit ndërsa ai Jon gërryhet nga veprimtaria e detit.

Pas këtyre pyetjeve mësuesi mund të bëjë pyetje për të inkurajuar zgjidhjen e problemeve apo për të analizuar.

Mësuesi duhet të jetë një komunikues efektiv. Ai duhet:

Të tregojë komunikim verbal pozitiv duke:

- Qenë i sjellshëm, i respektuar, i qartë dhe lehtësisht i kuptueshëm;
- Qenë informues dhe njëkohësisht interesant;
- Krijuar hapësirë për pyetje dhe diskutim;
- Krijuar hapësirë që pyetjet të drejtohen pa frikë dhe përgjigjet pa stres dhe presion.
- Krijuar hapësirë që të vlerësohen dhe inkurajohen mendimet e secilit.

Të tregojë komunikim joverbal pozitiv duke:

- Përdorur gjuhën trupore;
- Përdorur të shprehurit me mimikë;
- Qenë aktiv

Të tregojë aftësi të mira dëgjuese duke:

- Dëgjuar informacionin që sjellin fëmijët;
- Menduar rreth informacionit dhe duke ofruar komente
- Drejtuar pyetje efektive

Disa barrierë të komunikimit me fëmijët në klasë janë: toni i zërit, gjuha trupore, tipi i pyetjeve, pamja e jashtme dhe sjellja.

II.2 PROCESI I TË NXËNIT



Fëmijët dhe të rriturit nxënë në mënyrë më efektive në qoftë se përfshihen në mënyrë aktive në një proces.

Mbi procesin e të nxënit ka shumë teori dhe gjithashtu klasifikime të shumta të stileve të të nxënit. Por, për të mos i hyrë hollësisht këtij fenomeni, po ndalemi në tre mënyra kryesore (kyçe) të të nxënit që mund të klasifikohen si:

- Vizuale
- Auditive
- Kinestetike

Të gjithë ne kemi elementë të secilit stil të të nxënit, megjithëse, zakonisht ne kemi preferencë për njërin nga stilet e mësipërme. Po kështu ndodh edhe me nxënësit.

Mësuesi mund dhe duhet ta përdorë stilin e të nxënit të fëmijës për ta inkurajuar atë të nxërë, për ta motivuar dhe për ta bërë që të ndjehet i suksesshëm. Megjithatë, mësuesi duhet gjithashtu ta inkurajojë nxënësin të provojë stilet e ndryshme dhe ta mësojë se si të përdorë secilin prej tyre në jetë.

Stili i të nxënit	Tiparet e nxënësit	Këshilla për veprimtari mësimdhënëse
Të nxënit vizual	<ul style="list-style-type: none"> • Preferon pikturën/ diagramet e grafikët • Ka nevojë të krijojë pamje apo përfytyrime mendore të gjalla për të ruajtur informacionin. • Pëlqen të vëzhgojë hartat, grafikët, piktura dhe video. 	<ul style="list-style-type: none"> • Përdorimi i materialeve vizive si piktura, harta, grafikë, etj. • Hetimi dhe kuptimi i faktit që nxënësi është i qartë dhe kupton mirë përsa kohë ju flisni, që do të thotë se ata kuptojnë e lexojnë gjuhën trupore dhe shprehjen e fytyrës. • Përdorimi i ngjyrave për të nënvizuar çështjet e rëndësishme në tekst. • Krijimi i mundësive që nxënësi të marrë shënime dhe të punojë me fletë pune. • Përdorimi i pikturave ose i brainstorming-ut. • Krijimi i hapësirave që nxënësit të shkruajnë një histori dhe ta ilustrojnë atë. • Krijimi i mundësive që nxënësit të punojnë të qetë larg nga shqetësimet verbale. • Sigurimi i librave me piktura dhe diagrame për të lexuar.
Të nxënit auditiv	<ul style="list-style-type: none"> • Mëson më mirë përmes leksionit verbal, diskutimeve, duke thënë mendimet e tij por njëkohësisht duke dëgjuar atë që të tjerët thonë. • Interpretin kuptimin e gjërave thelbësore në një fjalim përmes dëgjimit të tonit, lartësisë dhe shpejtësisë së zërit, etj. • Informacioni i shkruar mund të ketë shumë pak kuptim për të në qoftë se ai mund ta dëgjojë atë. 	<ul style="list-style-type: none"> • Krijimi i mundësive që nxënësit të marrin pjesë në diskutimet dhe debatet e klasës. • Sigurimi i shanseve për të folur dhe prezantuar. • Përdorimi i një forme regjistrimi të informacionit se sa të shkruhet gjithçka. • Leximi i teksteve me zë. • Krijimi i mundësive që nxënësit të marrin pjesë në muzikë, këngë, etj. • Diskutimi verbalisht i ideve. • Diktimi ndërsa nxënësit po shkruajnë. • Përdorimi i anekdotave për të demonstruar një pikëpamje.

<p>Të nxënit kinestetik (prekja/fizike)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shprehet përmes lëvizjeve dhe me ndërveprim në hapësirën përreth tij. • Ka një sens të mirë ekuilibri dhe koordinim të syrit e dorës, p.sh: lojërat me top. • Pëlqen kërcimin, sportet, eksperimentet, përdorimin e gjuhës trupore, veprimin, përdorimin e duarve për të krijuar ose ndërtuar. 	<ul style="list-style-type: none"> • Zhvillimi i sesioneve të shkurtra dhe lejimi i pushimeve nga ora në orë. • Krijimi i mundësisë për të lëvizur dhe punuar në qoftë se është e mundur. • Krijimi i mundësisë për përdorimin e ngjyrave për vizatim. • Prezantimi i punës së nxënësve me anë të posterave ose në lojë me role, etj. • Leximi i informacionit si fillim përceptazi dhe pastaj kthimi te ai dhe leximi më me shumë detaje.
--	--	---

Duke parë tabelën* që ka të bëjë me stilet e të nxënit dhe kolonën e tipareve të nxënësve së pari të shkon mendja menjëherë te stili që preferon vetë dhe më pas te ai që preferojnë nxënësit që kemi në klasat tona. A i njohim ne ato? A e dimë se të ndryshëm janë nxënësit në klasat tona?

Kolona e tretë, e cila ka të bëjë me veprimtari apo trajtime që mund të bëhen gjatë orës së mësimt, mund t'i vijë në ndihmë mësuesit për të planifikuar dhe zhvilluar veprimtaritë e përditshme në klasat e tij/saj si dhe mund të shtohet e të pasurohet nga ai me forma të reja veprimtarish.

Lënda: Biologji

Faktorët e ndotjes së ajrit

Qëllimi i kësaj veprimtarie konsiston në njohjen nga nxënësit të faktorëve të ndryshëm që ndikojnë në ndotjen e ajrit. Shpeshherë këta faktorë nuk janë të dukshëm. E megjithatë kjo ndotje ndodh çdo ditë, ajo shpërndahet ngado. Por me kalimin e kohës akumulimi i ndotjes së ajrit nis e shkatërron cilësinë e tij, duke ndikuar në pamjen tonë, shëndetin dhe cilësinë e jetës.

Mjetet e nevojshme: 4-5 shishe 2 litërshe transparente pa etiketë, 4 pigmente (ngjyra), lugë druri, një gotë e pastër

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Mbushni shisheet 2 litërshe me ujë. Lëroni nxënësit të imagjinojnë sikur uji në shishe është ajri në zonën ku ata jetojnë apo mësojnë.
2. Mbushni gotën e pastër me ujë dhe lëroni mënjanë. Vendosni çdo shishe në tavolinë dhe rreth çdo shisheje caktoni 4-5 nxënës.
3. Hapni shisheet me pigmente ngjyrash. Para se të hidhni pikat prej secilit pigment, trazoni ujin me lugën. Më pas hidhni nga një pikë pigment në çdo shishe dhe lëroni të përhapet në ujë për disa minuta. Mësuesi mund të lëvizë nga grupi në grup duke hedhur pigmentet. Përsëriteni këtë proces 3 herë radhazi por me pigmente të ndryshme. Lëroni ngjyrat të përzihen ne rrugë të natyrshme për rreth 5 minuta.
4. Ndërkohë që mësuesi/ja hedh nëpër shishe pigmentet me ngjyra të ndryshme, shpjegon se çdo ngjyrë përfaqëson disa burime të ndotjes së ajrit. Shembull:
 - E kuqja – Makinat dhe automjetet e tjera
 - Jeshile – Nafta dhe karburantet
 - Blu – Djegia e plehrave
 - etj

5. Pasi i përziëni ngjyrat mirë, krahasoni ujin në shishe me ujin e pastër në gotë. Pyetni nxënësit:
- Cilin ujë do të preferonin të pinin? Pse?
 - Po në rast se në vend të ujit do të kishte ajër, do të pëlqenin të thithnin atë me ngjyrë apo të pastrin?
 - Mendoni se ajri i pastër është i rëndësishëm për njeriun?
 - Cilët janë disa nga ndotësit e ajrit që njihni ju?
 - Mendoni se mund të bëni diçka për të ndikuar në pakësimin e kësaj ndotje. Nëse po, çfarë?

II. 3 VEPRIMTARITË DHE METODAT ME NË QENDËR NXËNËSIN



Çfarë është mësimi me në qendër nxënësin?

Mësimi me në qendër nxënësin:

- Është ai mësim i cili është aktiv, interaktiv dhe reflektiv.
- Fokusohet në atë që është e rëndësishme e realiste për nxënësit dhe jo e ngurtë e abstrakte për ta.
- Lejon nxënësit të marrin pjesë në një shumëllojshmëri aktivitete, shpesh në çifte apo grupe të vogla, ku ata mund të mësojnë nga njëri tjetri dhe gjithashtu mund të diskutojnë e ndajnë idetë e tyre.
- Përdor eksperiencat e vetë nxënësve dhe ngrihet mbi ato duke shtuar njohuritë dhe duke zhvilluar më tej aftësitë e nxënësve.
- Është ai mësim ku ekziston respekti reciprok mes nxënësve dhe mësuesit, ku lejohet komunikimi pozitiv për ndarjen e ideve dhe dëgjimin e të tjerëve.
- Përdor disiplinë pozitive për të mbështetur suksesin dhe për të inkurajuar nxënësit të përpiqen vazhdimisht.

Duke parë cilësitë e mësimdhënies me në qendër nxënësin vihet re se ajo do të thotë që edhe vetë mësuesi në klasë është një nxënës dhe jo i vetmi person që ka njohuritë. Prandaj, në këtë rast, mësuesi duhet të jetë një lehtësues i mirë dhe ai i cili mund të menaxhojë një klasë me nxënës të ndryshëm. Mësuesi gjithashtu, është e nevojshme të jetë i zoti të përdorë shumëllojshmëri materiale dhe të sigurojë të nxënë aktiv, interaktiv dhe reflektiv në gjirin e nxënësve.

Tabela e mëposhtme tregon katër fazat kryesore ku duhet të marrë pjesë nxënësi aktivisht për të arritur një të nxënë të suksesshëm. Pa dyshim që ky cikël i të nxënit përshtatet me mësimdhënien me në qendër nxënësin. Fazat e këtij cikli janë*:

* "Child Labour and Education" - IPEC draft training manual for education practitioners, October, 2005

	Fazat	Kërkon ...
1	Eksperienca	Aktivitete siç janë vizitat, loja në role, demonstrimi, puna në grupe, etj.
2	Reflektimi	Të menduarit rreth eksperiencave të kaluara dhe gjetja e domethënies së tyre
3	Nxjerrja e përfundimeve	Inkurajimin e nxënësve për të nxjerrë përfundime praktike eksperiencat dhe feedback i tyre dhe të tjerëve në klasë.
4	Aplikimi i mësimeve	Inkurajimin e nxënësve për të lidhur atë që është mësuar me jetën e tyre dhe /ose me situata të tjera të ndryshme.

Lënda: Gjuha amtare

Mandolina*

Objektivat: Në fund të zhvillimit të mësimit nxënësi duhet të jetë i aftë:

- të bëjë parashikime nisur nga disa terma kyçë;
- të lexojë për të kuptuar idetë e autorit dhe mesazhin e pjesës;
- të lexojë duke interpretuar dhe duke shprehur emocionet e brendshme;
- të lexojë për të njohur gjuhën e veprës dhe ta vlerësojë atë;
- të reflektojë ndaj sjelljeve të personazheve.

Fjalë kyçe: Tregim, autor, personazh, mesazh, fjalor, lexim me kuptim, interpretim, vlerësim.

Struktura e orës së mësimit

E	Parashikim me terma paraprakë	10'
R	Lexim i drejtuar	20'
R	Rrjeti i diskutimit	15'

Zhvillimi i mësimit

Evokimi (rrahje mendimesh & parashikim me terma paraprakë)

Mësuesi pyet nxënësit:

- Ç'është mandolina?

Nxënësit shprehin atë që u vjen në mendje për mandolinën.

MANDOLINA

Mësuesi shkruan në tabelë 4 fjalët: bie, mandolinë, blej, dëshiroj, dhe kërkon që me to nxënësit të ndërtojnë për dhjetë minuta një tregim të shkurtër.

Lexohen disa nga krijimet e nxënësve.

Mësuesi u thotë se më pas do të shohin se sa i janë afruar ata tregimit që do të lexojnë me parashikimet e tyre.

Realizimi i kuptimit (lexim i drejtuar)

Mësuesi kërkon vëmendjen e të gjithë nxënësve. Ai u shpjegon mënyrën se si do ta lexojnë pjesën. Tregimi do të lexohet deri te ndalesat që ka parashikuar mësuesi. Pas çdo ndalese do t'i përgjigjen pyetjeve që ka përgatitur mësuesi rreth asaj që ata lexuan. Hapet libri në faqen 14.

* Marrë nga "Mësimdhënia me në qendër nxënësin", QTKA, Tiranë 2005.

Ndalesa e parë. “Paratë tona ... në kinema”. Mësuesi pyet nxënësit:

- Ku i kishin fituar të hollat djemtë?
- Pse ishin të detyruar të punonin ata që në moshë të re?
- Për cilën kohë flet tregimi?
- Cilat janë ato fjalë që tregojnë se flitet për kohë të shkuara?
- A bënë mirë prindërit që nuk ua morën paratë fëmijëve?
- Si e kuptoni shprehjen “Mirësjellja na u shpërblye”?
- Si mendoni se do t’i prishin fëmijët paratë?
- Ku e kuptoni këtë?
- Çfarë parashikoni se do të ndodhë më tej në tregim?
- Ku e mbështesni këtë mendim?

Ndalesa e dytë. “Shkuam edhe ... cicërima zogjsh.” Mësuesi pyet nxënësit:

- Çfarë bënë fëmijët me paratë?
- A ndodhi siç e kishit parashikuar ju?
- Cilat ishin dyqanet e tyre të preferuara ? Pse?
- Cilat janë sipas mendimit tuaj gjërat dhe sendet më interesante që blenë fëmijët?
- Po të ishit ju në vend të tyre çfarë do të blinit?
- Çfarë ju bën përshtypje në çastin kur fëmijët panë mandolinën?
- Çfarë do të ndodhë më tej? Pse mendoni kështu? Ku e mbështetni parashikimin tuaj?

Ndalesa e tretë. “- Sa bën ... e blejmë?” Mësuesi pyet nxënësit:

- Për çfarë pyetën fëmijët?
- Pse çmimi i saj ishte i lirë?
- A bënë fëmijët pazar me shitësen?
- Çfarë do të thotë të bësh pazar?
- Çfarë periudhe kohore ka qenë dhe si ka qenë gjendja në atë kohë?
- Tregoni edhe situata të tjera që lidhen me këtë periudhë.
- Pse i pëlqeu Gjergjit mandolina kur vuri dorën mbi tela: se ishte e bukur, apo sepse ...?
- Si mendoni ju a do ta blejnë fëmijët mandolinën ? Pse?
- Si do të përfundojë tregimi?

Ndalesa e katërt. “- Me se ... bërë me krahë.” Mësuesi pyet nxënësit:

- Pse fëmijët vendosën ta blejnë menjëherë violinën?
- A ju pëlqen vendimi i tyre? Po sakrificat që ata bënë?
- Po ju a mund të bëni sakrificat të kësaj natyre? Nëse keni bërë, tregoni një rast kur ka ndodhur kjo.
- A ju pëlqeu vendimi i fëmijëve për mënyrën si do ta përdornin mandolinën?
- A ju pëlqeu mbyllja e tregimit?
- Ka ndonjëri ndonjë ide për ta mbyllur në një mënyrë tjetër tregimin?
- Zgjidhni fjalët e vështira dhe shprehjet që ju kanë pëlqyer dhe ejani t’i shpjegojmë së bashku.
- A iu afrua parashikimeve tuaja ky tregim?

Reflektimi (rrjeti i diskutimit)
Diskutojmë së bashku

Po Jo

A duhet ta bënin fëmijët atë sakrificë për të blerë mandolinën? Pse?

Mësuesi shkruan në tabelë pyetjen sipas organizuesit të mësipërm grafik dhe u kërkon nxënësve që për 5 minuta të shkruajnë pa pushim argumente nën të dyja përgjigjet. Kur t'i përfundojnë ato, nxënësit do të vendosin të mbajnë një qëndrim të caktuar dhe të binden për të.

II.4 METODA DHE TEKNIKA MËSIMDHËNËSE

Pa dyshim që mësimdhënia në edukimin joformal duhet të jetë ndërvepruese. Kjo formë mësimdhënieje dallohet nga një karakteristikë themelore. Kjo ka të bëjë me faktin se funksioni dhe qëllimi kryesor i kësaj mësimdhënieje është të nxënit. Kjo është dhe karakteristika më themelore e të gjithë metodave dhe teknikave me në qendër nxënësin që përdoren në klasë.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten metodat dhe teknikat më të njohura dhe të përdorura që bëjnë pjesë të grupi i metodave me në qendër veprimtarinë e nxënësit.

Teknikat dhe metodat e punës në grup	Teknikat dhe metodat e hulumtimit
→ Diskutimi	→ Zgjidhja e problemit
→ Puna në grupe të vogla	→ Zbulimi
→ Grupet e ekspertëve	→ Projekti
→ Loja në role dhe simulimi	→ Studimi i rastit
	→ Vrojtimi
	→ Ekskursioni
	→ Eksperimenti

Më poshtë po trajtojmë shkurtimisht disa metoda e teknika me anë të të cilave mund të realizohen mirë objektivat e përcaktuara dhe të nxënit mund të jetë më i suksesshëm:

Diskutimi: Është një metodë në të cilën nxënësit bisedojnë së bashku rreth një teme të paracaktuar, me qëllim që të ndajnë, të marrin informacion për temën e dhënë. Procedura e realizimit të kësaj metode lidhet me zgjedhjen e një teme për diskutim, me përcaktimin e objektivit të studimit, me ndarjen e detyrave të pjesëmarrësve në diskutim. me krijimin e mjedisit për zhvillimin e diskutimit dhe me realizimin e diskutimit.

Loja me role: Është një metodë që kërkon ndërveprimin e dy a më shumë aktorëve në dramatizimin e një situatë të planifikuar për t'u luajtur nga nxënësi. Procedurat për realizimin e saj lidhen me kuptimin e situatës së lojës, përcaktimin e roleve, ndarja e tyre për nxënësit, të mësuarit e roleve (pjesëve) nga secili aktor dhe luajtja e rolit.

Puna në grupe: Është një teknikë që krijon mundësinë e kompozimit të grupeve me 4-5 nxënës, me nivele të ndryshme në mësim, me seks e racë të ndryshëm, që disku-

tojnë dhe punojnë së bashku për një temë të caktuar. Në të mund të trajtohen çështje të ndryshme. Çdo grup mirë është të ketë drejtuesin dhe raportuesin e tij. Grupet formohen në bazë të kritereve të ndryshëm por është e rëndësishme që ato të ndryshojnë kerr pas here.

Të pyeturit: Është një teknikë që ka në themel përdorimin e pyetjeve si dhe marrjen e përgjigjeve nga nxënësit. Në veprimtari qëllimi i përdorimit të tyre janë për të motivuar fëmijët, për t'i përfshirë në veprimtari, për të nxitur të menduarin, për të ndihmuar nxënësit në interpretimin e materialeve.

Paqja është ...

Qëllimi: Inkurajimi i nxënësve që të shkëmbejnë mendime në mënyrë që të kenë një mendim sa më të qartë për konceptin e paqes.

Objektivat: Në fund të kësaj veprimtarie nxënësit do të jenë të aftë të:

- thonë mendimet e tyre mbi konceptimin e paqes;
- shkëmbejnë perceptimet dhe të kuptuarit e tyre mbi paqen.

Materiale të nevojshme: Katër shirita letre për çdo nxënës, tabakë letre, markera.

Zhvillimi i veprimtarisë:

1. Duke punuar individualisht dhe duke shmangur diskutimin me njëri tjetrin, nxënësit shkruajnë në shirita letre të veçantë katër thënie të ndryshme që fillojnë: "Paqja është ...". Thëniet e shkruara duhet të pasqyrojnë të kuptuarit e tyre mbi konceptin e paqes.
2. Nxënësit formojnë grupe dhe kërkohet që në grup të shkëmbejnë dhe diskutojnë atë që kanë shkruar. Më pas në grup bihet dakord për një paragraf të shkurtër, të pranuar nga të gjithë, si përcaktim për paqen. Mesazhi shkruhet në një tabak letre dhe sipas dëshirës mund të shoqërohet me vizatime (simbole, figura personifikuese, etj)
3. Pasi secili grup prezanton punën e tij, mund të kalohet në diskutim me gjithë klasën për çështje që mund të kenë dalë në klasë gjatë veprimtarisë apo që mësuesi i mendon të përshtatshme.

Intervista: Është një metodë që realizohet mes dy nxënësve (njëri interviston ndërsa tjetri intervistohet). Intervistat në shkollën realizohen për probleme të thjeshta, por mësuesi duhet t'i ndihmojë nxënësit të përcaktojnë qëllimin e intervistës, të caktojë personat që do të intervistohen, të formulojnë pyetje të shkurtra, të qarta dhe të drejtpërdrejta.

Lojërat: Janë teknika të larmishme, të cilat vënë në bashkëpunim fëmijët me njëri-tjetrin ose me objekte të tjera, sipas rregullave të përcaktuara. Procedurat për realizimin e një loje fillojnë me njohjen e përmbajtjes së lojës, mësimi i rregullave të lojës dhe pjesëmarrjen e realizimin e lojës.

Filmi: Është një teknikë që e vë nxënësin në rolin e vëzhguesit me një pikësynim të qartë, për të arritur objektivat e paravendosura. Si procedurë metodike fillon me përgatitjen për të parë filmin, përcaktimin e qëllimeve se përse do të shikohet. Gjatë procesit të shikimit të filmit mblidhen të dhëna që u interesojnë pjesëmarrësve, të cilat pas përfundimit të filmit përpunohen dhe në fund nxënësit raportojnë dhe publikojnë përfundimet e nxjerra nga filmi.

Rrethi: Është një teknikë që i krijon mundësi nxënësve të shprehin lirshëm idetë, mendimet dhe ndjenjat e tyre. Procedura e kësaj teknike është vendosja e të gjithë nxënësve të klasës në një rreth. Një vendosje e tillë u tregon atyre se ata janë të gjithë të barabartë përballë njëri-tjetrit. Do të pranohet çdo lloj diskutimi i nxënësve, veçse secili nxënës ka të drejtë të flasë vetëm njëherë. Ata duhet të flasin me radhë, të dëgjojnë njëri-tjetrin dhe të mos ndërhyjnë për të ndërprerë të folurin e shokut/shoqes. Duhet krijuar gradualisht bashkëpunimi me njëri-tjetrin për të mos kundërshtuar, për të gjykuar përgjigjet e gabuara (nuk ka brenda rrethit përgjigje të tilla). Mësuesi duhet të thotë gjëra pozitive për t'i motivuar fëmijët të ndjehen, që ata dëgjoen nga të tjerët.

Votimi: Është një teknikë që në themel ka përdorimin e votës. Ajo shërben për t'i aftësuar fëmijët të marrin vendime në grup për të zgjedhur një shok/ shoqe në një post të caktuar, për të zgjedhur lojën që pëlqejnë, për t'u përfshirë në ndonjë veprimtari etj. Në shumë raste zbatimi i një teknike të tillë lehtëson shumë marrëdhëniet e bashkëpunimit në klasë. Si procedurë fillon me prezantimin e kandidatit, ose alternativës për të cilën do të votohet. Votimi do të jetë i fshehtë për secilin. Diskutohet rreth kandidatëve ose alternativave të prezantuara. Realizohet votimi. Llogariten rezultatet dhe në fund publikimi i alternativës së fituar.

Gazeta: Kompozimi dhe hartimi i një gazete shërben që nxënësit të shprehin lirshëm idetë dhe mendimet e tyre duke plotësuar dhe një të drejtë të tyre. Bërja e gazetës realizohet në mënyra të ndryshme p.sh: Nxënësit shkruajnë, vizatojnë, skicojnë idetë e mendimet që duan të shprehin. Ata emërtojnë gazetën e tyre. Një variant tjetër është krijimi i gazetës me materiale të prera nga gazeta, revista që ata pëlqejnë. Gazeta mund të shërbejë dhe për të edukuar respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre, por dhe realizimin e detyrave dhe përgjegjësi të tyre. Realizimi i gazetës kërkon bashkëpunim të lartë të nxënësve, veprimtari të thellë krijuese si dhe imagjinatë e fantazi. Gazeta duhet të zgjojë interes tek nxënësit, aty ata të gjejnë ngrohtësi e probleme të jetës së tyre.

Kutia e fjalëve

Qëllimi: Të ndihmojë nxënësit, që në një mënyrë të thjeshtë, të lidhin mendimet me ndjenjat e tyre lidhur me fëmijët e moshës së tyre që punojnë.

Objektivat: Në fund të veprimtarisë nxënësit duhet të jenë të aftë të:

- Komunikojë mendimet dhe ndjenjat e tij lidhur me punën e fëmijëve;
- Marrë pjesë në një diskutim interaktiv lidhur me problemet që lidhen me punën e fëmijëve.

Materiale të nevojshme: Letër A4, një kuti kartoni.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. I kërkohet nxënësve të mendojnë për ndjenjat dhe emocionet që i lindin kur imagjinojnë ose shohin fëmijët që kanë lënë shkollën dhe punojnë në rrugë duke shitur apo lypur. Pastaj nxënësit duhet të shkruajnë në një letër tre nga emocionet e tyre, duke përdorur një fjalë për secilin emocion, si për shembull: "i vetmuar", "i uritur", "i trishtuar", "i lodhur" etj. Kur secili nga nxënësit i ka shkruar tre fjalët i kërkohet që ato ti ndajë në tre shirita apo copa letre në mënyrë që scili shirit të ketë të shkruar njëren fjalë.
2. Më pas kalohet me një kuti kartoni apo një mbajtëse tjetër të përshtatshme pranë çdo nxënësi në mënyrë që ai t'i hedhë brenda tre shiritat e letrës. Letrat në kuti përzihen dhe kalohet përsëri pranë secilit nxënës në mënyrë që secili të tërheqë një shirit letre

më një fjalë nga kutia. Në këtë fazë i kërkohet nxënësve që, duke përdorur fjalën që kanë marrë nga kutia, të ndërtojnë një fjali e cila të shprehë ndjenjat lidhur me punën e fëmijëve si dhe të përmbajë fjalën e dhënë. Nxënësit, në këtë rast, duhet ta vendosin veten në vend të fëmijëve që punojnë në rrugë ose lypin. Fjalitë duhet të fillojnë me shprehjet të tilla ku të jetë përfshirë fjala e zgjedhur: “Unë jam i vetmuar sepse...”, “Unë jam i frikësuar sepse ...”, “Unë jam i uritur sepse ...” etj.

3. Inkurajohen nxënësit për të kaluar në një diskutim të përbashkët me të gjithë klasën për ndjenjat dhe emocionet që i lindin fëmijëve kur ata e imagjinojnë veten në vend të fëmijëve që kanë braktisur shkollën dhe punojnë në rrugë. Bëhet kujdes që diskutimi të angazhojë sa më shumë nxënës të klasës.

II. 5 MENAXHIMI I KLASËS

Menaxhimi i klasës përbëhet kryesisht nga aspekti fizik dhe social i tij dhe është përgjegjësi e mësuesit dhe e nxënësve për ta siguruar dhe për ta mbrojtur në mënyrë që ai të jetë sa më efektiv për zhvillimin me sukses të mësimt.

Disa aspekte kyç të menaxhimit të klasës janë:

- Mësime të planifikuara mirë dhe interesante;
- Zhvillimi i marrëdhënieve pozitive në klasë;
- Motivimi i nxënësve për të nxënë;
- Rregullat e klasës;
- Disiplinë pozitive në klasë;
- Aftësi komunikuese të mira të mësuesit dhe nxënësve.

II. 6 MOTIVIMI I NXËNËSVE

Nxënësit që vijnë në klasat joformale mësojnë dhe nxënë më mirë atëherë kur janë të motivuar. Kjo ndodh atëherë kur ata:

- Janë të qartë për veprimtaritë që po kryejnë dhe qëllimin që ato kanë
- Mund të punojnë vetë duke u mbështetur në njohuritë që ata vetë kanë
- Marrin pjesë aktivisht gjatë zhvillimit të veprimtarive duke i krijuar hapësirë që të përdorin gjuhën dhe perceptimet e tyre për të kuptuar.

Përveç kësaj, nxënësit që marrin pjesë në këto klasa do të përfshiheshin më aktivisht në veprimtaritë e zhvilluara në qoftë se ata:

- Kanë një mjedis të përshtatshëm dhe i siguron mundësi të punojnë së bashku me të tjerët dhe po ashtu e çliron nga presioni i notës apo i gabimit.
- Kanë një sërë mundësi zgjedhjesh për çfarë, kur dhe si duan të mësojnë
- Kanë kohë të mendojnë dhe të reflektojnë rreth asaj që kanë mësuar.

II.7 PLANIFIKIMI I MËSIMDHËNIES

Planifikimi është një pjesë e rëndësishme e punës së çdo mësuesi. Zemra e planifikimit është marrja e vendimeve. Për çdo plan mësimor që mësuesi duhet të bëjë i

duhet të vendosë se cilat janë objektivat ose qëllimet për çdo veprimtari, cilat mjete janë të përshtatshme për të zhvilluar veprimtarinë, cilat metoda dhe teknika duhet të përdoren që të përmbushen objektivat dhe se si do të vlerësoni arritjet e nxënësve. Ky proces i marrjes së vendimeve është sa i vështirë dhe i komplikuar për faktin se ka kaq shumë strategji mësimdhënieje dhe variante veprimtarish sa ka dhe mësues.



Në planifikimin e mësimit në klasat joformale janë thelbësore dy elementë:

- Të vendosësh se çfarë dëshiron të përmbushet, dhe
- Se si do të ecet për të përmbushur atë.

Kjo kërkon që mësuesi (dhe ndoshta edhe nxënësit) t'i drejtojnë vetes pyetjet e mëposhtme:

1. Çfarë dua të arrij?
2. Si do ta arrij atë?
3. Kush do t'i përmbushë ato?
4. Kur dhe në çfarë radhe do të bëhen gjërat?
5. Cilat burime janë të përshtatshme?
6. Çfarë materialesh dhe mjetesht janë të nevojshme?
7. Si do ti nis gjërat?
8. Si do të vijojnë ato?
9. Si mund të kuptoj në se ja kam arritur qëllimeve të mia?

Lënda: Biologji

Çfarë arome ndjeni?

Qëllimi i kësaj veprimtarie konsiston në faktin që nxënësit përmes analogjive me eksperimente që kryhen në klasë të kuptojë rëndësinë e ajrit për jetën dhe mënyrën sesi i ajri i ndotur zhvendoset nga një rajon në tjetrin.

Materialet e nevojshme: Hudhra, thikë dhe pjatë, ventilator

Zhvillimi i veprimtarisë

Bëj kujdes! Demonstroji nxënësve rolin e erës në shpërndarjen e ndotjes në ajër.

1. Kërkojuni nxënësve të kthejnë kurrizin nga ju dhe të mbyllin sytë. Pritni hudhrat dhe përmes ventilatorit shpërndani erën e hudhrës në klasë. Kërkojuni nxënësve të ngrenë duart lart sapo të ndjejnë aromën.
2. Shënoni në tabelë kohën e përafërt kur nxënësi i parë dhe i fundit ngriti dorën. Diferencat kohore tregojnë mënyrën sesi ajri qarkullon nëpër klasë.
3. Drejto pyetje:
 - Çfarë provoni kur ndjeni erën e rëndë të hudhrës?
 - Mendoni që mund të qëndroni për një kohë të gjatë me një ajër të tillë në klasë?
 - Po në rast se do të mbanit frymën, sa mendoni se mund të zgjasë?
 - Si gjykoni, ventilatori e përshpejtoi përhapjen e aromës?
 - Ç'mund të thoni për rolin e erës në shpërndarjen e pluhurit?
4. Ndjesia e nuhatjes është shumë e rëndësishme. Jepini detyrë nxënësve të përshkruajnë se ç'ndiejnë kur nuhasin ajrin në vende të ndryshme, si në një rrugë të pashtuar ku kalojnë makina, në një vend ku digjen plehurat, në një kopsht me pemë mimozash e bar të gjelbër, në plazh buzë detit, etj.

|| Pjesa III. Veprimtari të ndryshme për nxënësit

Lënda: Biologji

Të kujdesemi për shëndetin

Mjete të nevojshme: Një kopje e fletës së punës “Ah moj Eni” për secilin nxënës

Objektivat: Në fund të këtij aktiviteti nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të njohin disa nga rreziqet e jetës së përditshme që u kanosen atyre;
- të dallojnë pasojat e veprimeve që ata bëjnë;

Zhvillimi i veprimtarisë

Kjo është një veprimtari e thjeshtë për të tërhequr vëmendjen e nxënësve mbi disa rreziqe të jetës së përditshme që dëmtojnë shëndetin e tyre ndërkaq që synohet që ata të mendojnë dhe për pasojat e këtyre veprimeve si dhe rrugët për shmangien e tyre. Veprimtaria angazhon gjithë masën e nxënësve në mënyrë aktive si dhe nxit bashkëpunimin dhe diskutimin mes tyre.

1. Mësuesi i kërkon nxënësve që të dëgjojnë me kujdes historinë e Enit që ai do t’u lexojë. Po kështu mësuesi i kërkon nxënësve që kur të dëgjojnë tregimin sa herë që ata të kuptojnë që Eni ka bërë diçka që është e rrezikshme ose dëmton shëndetin e saj të bëjnë një shenjë. Për këtë shenjë mësuesi me nxënësit bien dakord paraprakisht. P.sh: Kur thuhet në tregim që Eni rrëshqiti shkallëve të gjithë nxënësit që e perceptojnë si një veprim me rrezik bëjnë “Auuuu...” ose bëjnë një shënim në fletë ose një veprim tjetër për të cilin bihet dakord.
2. Ndërkohë që mësuesi lexon, sa herë që nxënësit bëjnë veprimin apo zhurmën (për të cilën ata kanë vendosur), ai ndalon leximin dhe i kërkon nxënësve që në çift (dy nxënës të ulur në një bankë) të diskutojnë apo t’i thoni njëri tjetri se çfarë rreziku mund të paraqesë ai veprim që bëri Eni (janë të lejueshme të gjitha llojet e interpretimeve). Më pas diskutimi mund të përqendrohet dhe në atë se si mund të ulet ky rrezik për shëndetin.

Shënim: Kjo veprimtari mund të zhvillohet në orët që trajtohen tema të lidhura me kujdesin për shëndetin. Mbase mund të nevojitet që mësuesi të japë në fillim të veprimtarisë shpjegimet e nevojshme se kush quhet veprim i rrezikshëm apo që dëmton shëndetin.

Shtrirje aktiviteti

Në fund të veprimtarisë së përshkruar më lart mund të kërkohet që tregimi të rishkurhet nga nxënësit duke vendosur të gjitha veprimet që nuk shfaqin rrezik për shëndetin për të cilat ata kanë rënë dakord gjatë diskutimit.

Fletë pune

Ah moj Eni!

Eni një ditë u zgjua shumë e gjallë dhe plot gëzim. Ajo kërceu nga krevati dhe rrëshqiti shkallëve për të parë se çfarë po përgatiste mamaja e saj për mëngjes. Mbi sobë ishte një enë e madhe dhe kështu që nuk mund të shihje se ç'kishte brenda. Eni u afrua dhe zhyti gishtin brenda në të. Ua... e qullët, e pështirë - tha ajo.

Enit i pëlqente buka e thekur me çokokrem, prandaj ajo mori bukën e bardhë dhe preu një fetë të hollë me një thikë të madhe buke shumë të mprehtë. Meqenëse kavanozi i çokokremit ishte në një sirtar të lartë ku ajo nuk e arrinte dot, Eni shkoi të merrte një stol i cili ishte i vjetër dhe lëvizte për të hipur në të në mënyrë që të arrinte për ta marrë. Ndërkohë, feta e bukës, e cila ishte vënë në thekëse, kërceu sipër dhe si për çudi Eni e kapi me dorë dhe e vuri në pjatë. Gjalpi ishte i hapur mbi tavolinë dhe afër tij qëndronte macja e cila shikonte shumë e kënaqur gati për ta shijuar. Eni e përzuri nga tavolina, mori gjalpin që kishte mbetur e shtroi mbi bukën e thekur dhe pastaj vuri mbi të çokokremin. Mmm... shumë e shijshme, tha ajo!

Meqenëse ishte një ditë e bukur dhe e ngrohtë, Eni veshi patinat e saj, të cilat ishin tashmë dy masa më të vogla, dhe shkoi jashtë. Ajo ishte larg nga shtëpia kur u kujtua se kishte harruar të vendoste mbrojtëset për gjunjët dhe bërrylat. Oh, mirë - tashmë jam shumë larg mendoi ajo. Në këtë moment ajo ishte në majë të një tatëpjete dhe filloi të zbriste poshtë me shpejtësi duke lënë erën që të frynte me forcë në fytyrën dhe trupin e saj. Rrugës, duke zbritur poshtë ajo ndaloi anash rrugës për të shijuar disa manaferra të kuqe që ishin në një kaçube të vogël. Uhh! Qenkan kaq të hidhura, tha ajo!

Me tu kthyer në shtëpi, Eni hoqi patinat dhe shkoi të kërkonte një biçikletë të saj të vjetër. Ajo ishte në garazh me një sërë veglash të kopshtit që ishin vënë si një pìrg i madh mbi të. Eni hoqi e hoqi deri sa më në fund biçikleta ishte e lirë. Ajo e mori biçikletën megjithëse e dinte që nuk i kishte frenat e pasme. Ajo ishte përsëri në majë të tatëpjetës kur u kujtua se kishte harruar kapelën mbrojtëse të kokës. Oh mirë - prapë jam larg për tu kthyer mendoi. Zbriti poshtë me shpejtësi me erën që i përplasej furishëm në fytyrë dhe i bënte flokët e saj të gjatë të fluturonin sa andej këtej. Eni vazhdoi të ecte me biçikletë në vendin e saj të preferuar që kapërcente lumin, ku uji i lumit kalonte mbi gurët e vendosur për të kaluar lumin. Duke e lënë biçikletën anash lumit, ajo hoqi këpucët dhe filloi të kërcente nga guri në gur brenda në lumë. Sa mirë! litari i vjetër qëndronte akoma i varur si kolovarëse te rrapi i vjetër në buzë të ujit. Ajo menjëherë e mbërtheu litarin, hipi në kolovarëse dhe e la veten të kolovitej me sa fuqi që kishte mbi lumë.

Ishte kaq e këndshme për Enin andej nga lumi sa që ajo kaloi gjithë mëngjesin atje duke mos treguar fare kujdes për diellin që i binte në fytyrë. Shkoi vonë, ajo filloi të ndiente lodhje dhe shumë etje. Mori pak ujë nga lumi me një gotë të vjetër kosi, piu ujë dhe u nis rrugës për në shtëpi.

Lënda: Matematikë

Unë di të ndërtoj diagrame

Objektivat: Nxënësit të jenë të aftë të:

- Grumbullojnë të dhëna statistikore për dukuri të ndryshme
- Hartojnë vetë kritere klasifikimi të objekteve e dukurive
- Bëjnë tabela të thjeshta të dhënash statistikore
- Ndërtojnë diagramet përkatëse
- “Lexojnë” diagramet që i kanë “ndërtuar” vetë

Mjetet: Fletë me katrorë, vizore, lapsa me ngjyra, tabela të parapërgatitura në dërrasë


Zhvillimi i veprimtarisë

1. Disa ditë para zhvillimit të mësimit, porositen nxënësit që të marrin muajt e lindjes të të gjithë personave të familjes si dhe të disa personave të tjerë të afërt (fqinjë, kushërinj, shokë etj). Secili nxënës të marrë të dhëna për rreth 20 persona. Të dhënat të hidhen në tabelën si më poshtë (e cila u jepet nxënësve nga mësuesja).

Nr.	Muaji	Emrat e personave
1.	JANAR	
2.	SHKURT	
3.	MARS	
4.	PRILL	
5.	MAJ	
6.	QERSHOR	
7.	KORRIK	
8.	GUSHT	
9.	SHTATOR	
10.	TETOR	
11.	NËNTOR	
12.	DHJETOR	

2. Klasa ndahet në grupe me 6-8 nxënës. Në secilin grup zhvillohen diskutimet si më poshtë: Nxënësi a) tregon për personat që në tabelën e tij kanë lindur në muajin Janar. Për secilin prej tyre jep edhe cilësi të veçanta si Bujari është xhaxhai im, është 43 vjeç, punon inxhinier, i pëlqen shumë muzika etj. Nxënësi b) tregon për personat që kanë lindur në muajin shkurt, e kështu me radhë etj. Kështu bëhet një tabelë përmbledhëse e grupit (duke mbledhur personat e lindur në të njëjtin muaj)

3. Secilit grup i jepet nga mësuesi diagrami i mëposhtëm. Grupi ndërton diagramin re tij. Më pas grupet i ndërrojnë diagramet dhe përfaqësuesit e tyre bëjnë leximin e diagrameve të grupit tjetër



4. Grupet i drejtojnë pyetje njeri tjetrit. P.sh. “Në cilin muaj kanë lindur më shumë persona? Në cilin muaj nuk ka lindur asnjë person? Sa persona më shumë kanë lindur në muajin prill në krahasim me muajin shtator? etj

Lënda: Histori**Kultura ilire**

Mjete të nevojshme: Fotografi me pamje nga gjetjet ilire ose album arkeologjik për gjithë klasën, hartë e Ballkanit, dërrasë e zezë.

Objektivat: Në fund të këtij aktiviteti nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të identifikojnë karakteristikat e artit ilir dhe të veshjes ilire;
- të përmendë karakteristikat e përbashkëta me artin dhe veshjen sot;
- të identifikojnë lidhjen mes të sotmes dhe traditës.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Pasim mësuesi iu ka treguar nxënësve fotografitë që tregojnë objekte nga gjetjet në vendbanimet ilire me anë të një brainstorming-u kërkon nga nxënësit të tregojnë veçoritë e objekteve, vizatimeve, gjuhës dhe mënyrës së jetesës së ilirëve duke i shënuar në dërrasë. Më pas mësuesi bën një përmbledhje dhe një renditje të tyre.
2. Ftohen dy nxënës një djalë dhe një vajzë para klasës. Ata pasi kanë parë fotografitë që tregojnë veshjet e grave dhe të burrave ilir në libër apo në album, supozojnë se janë veshur me veshje ilire dhe bëjnë përshkrimin e veshjes që ato mbajnë.
3. Mësuesi diskuton me nxënësit çështjet si:
 - A gjejmë sot elementë të kulturës ilire në poçeri, skulpturë, gjuhë e mënyrë jetese? Cilët janë disa?
 - Veshja jonë e përditshme a ka lidhje me veshjen tradicionale? Cilët elementë të veshjes janë trashëguar?
 - Si mendoni se do të ndryshojë veshja jonë në të ardhmen?
4. Duke parë hartën e Ballkanit dhe shtrirjen e Ilirisë ftohen nxënësit të diskutojnë në se ka ndryshuar veshja nga njëra zonë në tjetrën.

Lënda: Matematikë, biologji**Etiketat e ushqimeve**

Objektivat: Nxënësit të jenë të aftë të:

- Lexojnë etiketat e artikujve të ndryshëm në mënyrë që të informohen për kohën e tyre të skadencës.
- Realizuar llogaritje lidhur me kohën (kalendari në vite, muaj, ditë).

Mjete të nevojshme: Etiketa dhe ambalazhe të ndryshme ushqimesh.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Klasa ndahet në grupe me 6-8 nxënës. Secilit grup i jepen etiketa e letra ambalazhi të artikujve të ndryshëm (10-12 etiketa) dhe u kërkohet t'i klasifikojnë ato. Është e udhës që nxënësit ta realizojnë vetë grupimin. P.sh. mund të bëhet grupimi veç për vajrat, veç për çokollatat e kamelet, veç për produktet e qumështit, veç për produktet e mishit etj. Grupet diskutojnë dhe japin argumentet përkatës për mënyrën e grupimit dhe vendoset grupimi përfundimtar për të gjithë klasën.
2. Secilit grup i jepen etiketat e një klasifikimi. P.sh. grupit të parë etiketat e produk-

teve të qumështit, grupit të dytë ato të produkteve të sheqerit etj. Nxënësit brenda grupit komentojnë etiketat që disponojnë. Në mënyrë të veçantë duhet vëzhguar e diskutuar lidhur me datën e skadencës. Grupet llogarisin për secilin produkt kohën që ka kaluar nga afati i skadencës apo kohën që ka mbetur deri në skadencë. Llogaritjet mund të bëhen me vite, me muaj, me javë apo me ditë. Artikujt që janë në prag të skadencës mund të grupohen më vete duke u shoqëruar me mbishkrime të veçanta si « kujdes, ruaju ».

3. Nxitet një debat i lirë me nxënësit e të gjithë klasës. Tregohen raste të ndryshme të publikuara të artikujve piratë e pa etiketa. Nxirren konkluzione për rrezikun e përdorimit të tyre. Bëhen diskutime për rrezikun e përdorimit të artikujve të skaduar duke i klasifikuar edhe ato. P.sh koha e skadencës për një artikull i ul atij vlerat , por nuk e bën të rrezikshëm për shëndetin (p.sh një parfum,një krem etj). Për një artikull tjetër ushqimor që përmban vezë përdorimi pas skadencës mbart me vete rrezikun e helmimit. Një rëndësi të veçantë ka diskutimi lidhur me kohën e skadencës së ilaçeve, aq më tepër që ato janë të shkruara në gjuhë të huaj. Diskutimi lidhur me këtë të çojë në konkluzionin që prindërit të shikojnë me kujdes e të kërkojnë nga farmacisti respektimin e kohës së skadencës së ilaçeve. Lidhur me këtë nxënësit të japin shembuj nga përvoja në familjet e tyre.

Lënda: Gjeografia e Shqipërisë

Alpet shqiptare

Objektivat: Në fund të këtij aktiviteti nxënësit duhet të jenë të aftë:

- të përcaktojnë pozitën gjeografike dhe disa nga format kryesore të relievit të alpeve në artën fizike të Shqipërisë;
- të evidentojnë vlerat turistike të këtij rajoni;
- të thonë veçoritë e popullsisë dhe të shpërndarjes së saj në këtë zonë.

Mjete të nevojshme: Hartë e Shqipërisë për gjithë klasën, hartë e Shqipërisë për çdo nxënës, tabakë letre për çdo grup, lapostil për çdo grup, ngjitës, gërshërë.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Pasi është ndarë klasa në grupe (mirë është 5 grupe), mësuesi fillon prezantimin e detyrës që ka secili grup. (Për të realizuar ndarjen në grupe përdorni forma të ndryshme në mënyrë që përbërja e tyre të mos jetë e njëjtë në çdo aktivitet). Detyra e çdo grupi është kjo:

Supozoni se punoni në një agjenci turistike dhe iu duhet të bëni një fletë palosje (reklamë) për Alpet e Shqipërisë. Në hartimin e tekstit duhet të keni parasysh që me anën e tij të tërhiqni sa më shumë turistë për ta vizituar këtë zonë. Jeni të lirë në strukturimin e tekstit, por do të mbani parasysh që në të flitet për:

- ku shtrihen Alpet shqiptare;
- si është relievi (format që mbizotërojnë) duke përmendur disa male apo lugina;
- ç' klimë ka;
- disa lumenj kryesor;
- bota shtazore e bimore;
- bukuritë që ofron relievi;
- popullsia që jeton në këtë zonë;

- disa qendra kryesore;
- si paraqitet gjendja e ndotjes së mjedisit;
- e ardhmja e këtij rajoni.

Detyra do të realizohet duke u konsultuar me hartat fizike dhe administrative të Shqipërisë që keni para.

Mësuesi për ta lehtësuar të kuptuarin e detyrës mund t'i shkruajë në dërrasën e zezë çështjet të cilat duhet të pasqyrohen në tekstin që do të shkruhet.

Pasi i lihet koha e mjaftueshme për ta realizuar detyrën, secili grup prezanton me një përfaqësues punën e tij e cila është e paraqitur në tabakët e letrës që afishohen në muret e klasës. Në fund të prezantimit mësuesi bën përmbledhjen duke shtuar informacionin e pa nxjerrë nga nxënësit.

2. Më pas kalohet në një diskutim të përbashkët për çështjet si:

- A ka burime të mjaftueshme ky rajon për zhvillimin e turizmit?
- Po në të ardhmen ç'ofron ky rajon?
- A njihni rajone turistike në botë të ngjashme për nga kushtet fiziko-gjeografike me alpet tona?
- Nëse ndonjëri e ka vizituar këtë rajon ç'përshtypje sjell ai?

Shënim: Aktiviteti mund të zhvillohet dhe në orë të tjera duke përdorur analogjinë për rajonet e tjera fiziko-gjeografike të Shqipërisë.

Të drejtat dhe përgjegjësitë tona në klasë

Qëllimi: Të ndërgjegjësohen nxënësit për faktin që kur flitet për të drejtat e tyre, gjithmonë flitet dhe për përgjegjësitë që shoqërojnë përmbushjen e tyre.

Objektivat: Në fund të veprimtarisë nxënësit duhet të jenë të aftë të:

- Të njohin të drejtat që ata kanë në klasën e tyre;
- Të dallojnë përgjegjësitë që lidhen me përmbushjen e një të drejte.
- Të përdorin forma demokratike për të arritur në konsensus me njëri tjetrin.

Materiale të nevojshme: Një copë e vogël letre për çdo nxënës, fletë të mëdha letre të bardhë, ngjitës, lapostila.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Mësuesi shpërndan nga një copë letër të bardhë të gjithë nxënësve në klasë dhe i kërkon atyre që të shkruajnë në të një të drejtë që ata e shohin se duhet ta gëzojnë në klasë. Edhe vetë mësuesi shkruan një të drejtë. Copat e letrës mbledhen nga mësuesi, lexohen me zë një nga një dhe votohen. Ato të drejta të shkruara që marrin më shumë se gjysmën e votave, pranohen, shkruhen në një tabak të madh letre dhe e gjithë lista e këtyre të drejtave pranohet si kodi i të drejtave në klasën e tyre. Kjo listë qëndron e varur në klasë.
2. Të drejtat e marra nga kodi i të drejtave të klasës shkruhen në copa letre të ndara dhe vendosen në një kuti apo vazo. Nxënësit formojnë grupe katërshe. Çdo grup merr një copë letre ku është shkruar një e drejtë dhe krahas saj ata hartojnë një listë të përgjegjësiave që ata apo të tjerë kanë për ushtrimin e së drejtës për të cilën diskutohet. Grupet merr copa letre të tjera derisa kutia të boshatiset.
3. Më pas çdo grup paraqet të drejtat dhe përgjegjësitë që lidhen me to, para klasës.

Lista e përgjegjësive shkruhet në një tabak letre duke u diskutuar dhe miratuar nga e gjithë klasa deri sa të krijohet një listë që le të quhet kodi i përgjegjësive të klasës, i cili është plotësues i kodit të së drejtave. Këto dy lista shkruhen mirë në dy stenda dhe qëndrojnë të afishuara në muret e klasës.

Duke ndjekur turmën

Objektivat: Në fund të këtij aktiviteti nxënësit duhet:

- Të kuptojnë se sa i madh është presioni i bashkëmoshatarëve.
- Të ilustrojnë efektin e ndikimit të bashkëmoshatarëve mbi një njeri që ballafaqohet me një vendim.

Materialet e nevojshme: Fije letre të vogla në të cilat janë shkruar fjalët “Ha” dhe “Mos ha”, një tas me karamеле.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Klasa formon një rreth ku në mes vendoset tasi me karamеле. Çdo nxënësi i jepet nga një fije letër (disa nga letrat lexojnë “Ha”, disa “Mos ha”). Udhëzohen nxënësit se objekti i veprimtarisë është që ata që kanë letrat “Ha” t’u bëjnë presion atyre që kanë letrat “Mos ha” që të hanë karamеле.
2. Më pas diskutohet me nxënësit rreth presionit të bashkëmoshatarëve mbi shoku – shokun (në mënyrë të veçantë për të pirë duhan).

Shënim: Me mjaft kujdes mësuesi drejton diskutimin e nxënësve në atë mënyrë që nxënësit të sjellin përvoja nga jeta e tyre të presionit të bashkëmoshatarëve apo më të rriturve për të pirë duhan apo diçka tjetër.

Pamjet e prera

Qëllimi: Praktikimi i vëzhgimit të detajuar, interpretimit të pamjeve dhe fotografive, negociimi dhe vendosja e konsensusit.

Mjetet e nevojshme: Për secilin grup prej 3-4 nxënësish: një fotokopje e fotografisë e prerë në dy pjesë; një fletë muri (fleepchart); një laps; 2 markera me ngjyra të ndryshme dhe ngjites.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Nxënësit formojnë grupe me 3 ose 4 veta dhe secilit grup i jepet një pjesë e fotografisë së prerë. Ata e ngjisin atë në një tabak letre. Detyra e tyre e parë është të shprehin mes tyre ndjenjat, reagimet e para dhe pyetjet që i lindin duke parë këtë pjesë të fotografisë, duke i shkruar ato anash, përbri fotografisë. Detyra e dytë është, që nxënësit në grup të vendosin se çfarë mund të përmbajë fotografia në pjesë e prerë. Pasi ata bien dakord për këtë, vizatohet me laps vazhdimi i fotografisë, duke e bërë atë një fotografi të plotë ashtu si ata e mendojnë.
2. Më pas nga mësuesi shpërndahen kopjet e pjesës së dytë të fotografisë për çdo grup. Nxënësit e vendosin këtë mbi vizatimin e bërë nga ata dhe kështu plotësohet fotografia. Anëtarët e grupit shprehin ndjenjat, reagimet dhe pyetjet që i lindin duke parë këtë pamje të plotë dhe i shkruajnë ato anash fotografisë, tani duke

- përdorur një marker me ngjyrë tjetër.
3. Pas kësaj pason diskutimi rreth asaj se sa i afrohet vizatimi i bërë me laps fotografisë së vërtetë.

Shënim: Për të zhvilluar aktivitetin e paraqitur më sipër do të ishte mirë të zgjidhen fotografi apo pamje nga tekstet dhe nga burime të tjera, ku pjesa e fshehur e fotografisë të përmbajë një surprizë për nxënësit ose një material me vlerë që nxit diskutimin mes tyre. Në këtë mënyrë aktiviteti me fotografinë mund të përdoret me efektivitet si veprimtari ekstrakurrikulare për të diskutuar për çështje të ndryshme që na shqetësojnë sot.

Të lidhur me gjithë botën

Qëllimi: Ndërgjegjësimi i nxënësve mbi një sërë ndryshimesh që kanë shtetet njëri nga tjetri

Mjetet: harte politike e botës e fotokopjuar për çdo nxënës, laps.

Zhvillimi i veprimtarisë

Paraprakisht mësuesi bën një fotokopje të një harte politike të botës. Harta fotokopjuhet për secilin nxënës në klasë.

1. Inkurajohen nxënësit që të flasin për njerëz të afërm apo të njohur të cilët kanë emigruar në vende të ndryshme të botës.
2. ndahen nxënësit në grupe dhe i jepen kopjet e hartës së botës. Në grup nxënësit caktojnë shtetet ku kanë emigruar të afërmit e tyre. Ata mund t'i listojnë emrat e shteteve në një fletë letre.
3. Pas kësaj grupeve iu kërkohet të thonë disa veçori që ata dinë për shtete e zgjedhura. Këto veçori kanë të bëjnë me racën, gjuhën, klimën, ushqimet, muzikën, veshjen, monumentet, etj.
4. secili grup prezanton punën dhe mendimet e tyre para klasës. Puna e tyre mbështetet me komentet e mësuesit.

Variacion: kjo veprimtari mund të zhvillohet dhe në hartë memece dhe t'i kërkohet nxënësve të gjejnë shtetet me emrat e tyre. Pjesa tjetër e veprimtarisë zhvillohet si është përshkruar më sipër.

Efektet e punës

Qëllimi: Identifikimi i rreziqeve për shëndetin, para të cilave fëmijët e punësuar janë të ekspozuar;

Objektivat: Në fund të veprimtarisë nxënësit duhet të jenë të aftë të:

- identifikojnë disa lloje punësh që ato apo moshatarët e tyre bëjnë;
- vlerësojnë përfitimet dhe rreziqet që sjell puna që bëjnë fëmijët.

Materiale të nevojshme: Fletë pune për çdo nxënës, tabak letre, markera.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. Me anën e një brainstorming iu kërkohet nxënësve të listojnë lloje të ndryshme punësh që ato apo moshatarët e tyre bëjnë. Këto lloje punësh mund të përfshijnë, si punët e vogla dhe të dobishme, që ata apo moshatarët e tyre kryejnë, ashtu dhe punët e rënda apo që ata i konsiderojnë të papërshtatshme (si p.sh: lypës, shitës ambulant, fatorino, etj).
2. Më pas duke punuar në çift nxënësit plotësojnë fletën e punës që i është dhënë secilit prej tyre. Fleta e punës është e ndërtuar si një tabelë që nxënësit mund ta përgatisin dhe në një fletë formati A4

Lloji i punës	Përfitimet	Rreziqet/dëmet	Kush e ushtron këtë punë

Në të ata duhet të shkruajnë përkrah çdo lloji pune të thënë në fazën e parë të veprimtarisë, disa nga përfitimet që sjell kjo punë, disa nga rreziqet apo dëmet që ajo mund të shkaktojë dhe së fundi kush e ushtron më shumë këtë punë në zonën e tyre.

3. Në këtë fazë, tre çifte mblidhen së bashku dhe shkëmbejnë shënime të vëna në fletët e punës. Në këtë fazë nxënësit e një grupi mund të diskutojnë dhe debatojnë me njëri tjetrin rreth përfitimeve dhe dëmeve që sjellin punët e fëmijëve që ata kanë zgjedhur.
4. Më tej pasohet me një diskutim me gjithë klasën për çështje si:
 - A është secila punë një lloj e përdorshme nga fëmijët?
 - Për nxënësit, cilat janë punë të rrezikshme apo që nuk duhen kryer nga ata dhe pse?
 - Cilat janë rreziqet dhe dëmet më të mëdha që sjellin punët e konsideruara si të papërshtatshme nga nxënësit?
 - A ka raste kur ata janë angazhuar në punë të rrezikshme apo të dëmshme?

Dhuna

Qëllimi: Të shqyrtohen konceptet e dhunës së drejtpërdrejtë dhe asaj indirekte.

Objektivat: Në fund të kësaj veprimtarie nxënësit do të jenë të aftë të:

- dallojnë konceptet e dhunës së drejtpërdrejtë dhe asaj indirekte;
- të bashkëpunojnë në mënyrë efektive për të vendosur shembujt në diagramë;
- vlerësojnë kushtet që bëjnë të mundur krijimin e një klime paqeje në shoqëri.

Materiale të nevojshme: 3 shirita letre për çdo nxënës, tabak letre për çdo grup, ngjitës dhe marker për çdo grup.

Zhvillimi i veprimtarisë

1. I kërkohet nxënësve të shkruajnë tre shembuj të dhunës, dëmtimit, vrasjes apo injorimit që i është bërë një individ, një grupi shoqëror ose mirëqenies njerëzore, për të cilën ata kanë informacion apo kanë dëgjuar a lexuar. Çdo shembull duhet të shkruhet në një shirit letre të veçantë. Mirë është që njëri të jetë në nivel ndërpersonal, një në nivel komuniteti ose ndërkomunitar dhe një në nivel ndërkombëtar.

2. Klasës i është folur dhe shpjeguar që dhuna mund të jetë e drejtpërdrejtë, e cila ndodh në rastet e dhunës fizike ushtruar nga një ose më shumë persona kundrejt një ose disa të tjerëve, dhe indirekte e cila është dhuna e ushtruar ndaj njerëzve nga sistemet sociale, politike ekonomike dhe të besimit si dhe nëpërmjet abuzimit mendor ose psikologjik. Nxënësit formojnë grupe me 5 ose 6 veta dhe i tregojnë njëri tjetrit për shembujt e gjetur. Në një tabak letre ata (si grup) vizatojnë diagramin e Venit si në figurën 1. Nxënësve iu kërkohet të shqyrtojnë secilin shembull dhe ta vënë atë në pjesën e duhur të figurës. Pasi plotësohet figura, duke i ngjitur të 15 shembujt, prezantohet puna nga një përfaqësues i grupit.




Figura 1

3. Në fund të prezantimeve mund të kalohet në një diskutim me të gjithë nxënësit për probleme që lidhen me zhvillimin e veprimtarisë, me dhunën në përgjithësi dhe sigurimin e një klime paqeje në shkollë dhe në shoqëri. Disa probleme që mund të diskutohen mund të jenë:
- Çfarë vështirësish ndeshën grupet në vendosjen e shembujve në diagramë?
 - Pse ndodhin këto vështirësi?
 - Në ç' masë format e dhunës së drejtpërdrejtë dhe indirekte ishin të ndërlydhura?
 - Çilat mund të jenë mjetet e pranueshme dhe efektive për t'iu kundërvënë dhe zhdukur dhunën.
 - A mund të flitet për një klimë pozitive apo paqeje në komunitetin tuaj?
 - Etj.

Çështjet rreth të cilave do të diskutohen më tej mund të përcaktohen nga vetë mësuesi në varësi të situatës apo të kushteve në komunitetin e tyre.

Të drejtat në konflikt

Qëllimi: Shqyrtimi i konflikteve midis të drejtave të individëve

Objektivat: Në fund të kësaj veprimtarie nxënësit do të jenë të aftë të:

- dallojnë momentin kur të drejtat janë në konflikt;
- argumentojnë kur një e drejtë nuk duhet mohuar për asnjë arsye;
- bashkëpunojnë duke pranuar me qetësi mendimet dhe pikpamjet e njëri tjetrit.

Materiale të nevojshme: Një set i të drejtave në konflikt për çdo grup të prera nga fleta e punës.

Zhvillimi i aktivitetit

Nxënësit formojnë grupe prej 4-5 vetësh. Në secilin grup një nxënësi i jepet karta 1 nga fleta e punës dhe anëtarëve të tjerë të grupit karta 2. Pas pak minutash reflek-

timi, mësuesi i kërkon anëtarëve të secilit grup të marrin rolet e tyre dhe të përpiqen të sjellin argumente që lidhen me konfliktin e të drejtave në kartën e tyre. Herë pas here, mësuesi mund t'i kërkojë nxënësit që mban kartën 1 të ndërrojë vend me ndonjë nxënës tjetër në grup dhe të shkëmbejnë rolet. Rregulli është që çdo nxënës duhet të nisë argumentimin e vet kur tjetri nuk ka më për të thënë. Gjatë diskutimit të grupeve mësuesi mund të thotë me zë të lartë "Ngrirje" – sinjal ky, që do të thotë që të gjithë të pushojnë së foluri dhe po në atë çast mësuesi mund t'i japë fjalën një nxënësi të caktuar duke thënë "në jetë" dhe duke e prekur atë në sup. Në këtë mënyrë mësuesi organizon më mirë diskutimin në klasë si dhe heton nxënësit në drejtim të pikëpamjeve dhe argumenteve që sjellin. Një prekje tjetër në sup e "ngrin" përsëri nxënësin dhe procesi përsëritet me nxënës të tjerë, në grupe të tjerë.

2. Nxënësve të organizuar në grupe u lihen 5 minuta në dispozicion për të lexuar kartat 3 deri te 6 dhe për të diskutuar më pas pyetjen e shtruar për secilin rast që merret në shqyrtim. Në grup nxënësit i diskutojnë të katër rastet në mënyrë të tillë që secilit t'i lihet hapësirë për të thënë mendimin e tij/saj. Në fund të diskutimit, një përfaqësues i grupit prezanton mendimin e shokëve për secilin rast. Diskutimi i secilit rast mund të realizohet edhe duke marrë 2 prej nxënësve qëndrimin pro qeverisë dhe 2 të tjerët kundër qeverisë.

FLETË PUNE

Kartat e të drejtave në konflikt

<p>1. Një mbrëmje ju ktheheni nga një shëtitje me një CD të re që mezi prisni ta dëgjoni. E keni dëshiruar atë me kohë dhe më në fund e bletë me lekët e ditëlindjes. Njerëzit e familjes po shohin me interes TV në dhomën ku është vendosur dhe impianti i CD. As CD dhe as TV nuk mund të lëvizin.</p>	<p>2. Ju dhe pjesa më e madhe e familjes tuaj keni pasur një ditë shumë të ngarkuar dhe jeni shumë i lodhur, kështu që vendosni të kaloni një darkë të qetë para televizorit. Po e shijoni atë duke parë një film të shkëlqyer që tashmë është nga mesi. Papritur një pjesëtar i familjes vjen i ngazëllyer me një CD të re që do ta dëgjojë.</p>
<p>3. Një familje ka jetuar në të njëjtin vend që prej 50 vjetësh. Qeveria do ta detyrojë që të largohet, sepse shtëpia është në vendin ku do të kalojë një autostradë e re që do të ndërtohet. Shmangia e autostradës do t'i kushtonte shumë qeverisë. Familjes iu ofrua një goxha shumë për shtëpinë, por ata përsëri nuk donin të largoheshin. Ata thoshin se është e drejta e tyre ta mbajnë shtëpinë e vet. A duhet të detyrohen ata ta shesin atë?</p>	<p>4. Qeveria nxori një ligj të ri i cili ndalonte pirjen e duhanit në ambientet e brendshme të dyqaneve, kinemave, teatrove, restoranteve dhe ambienteve të tjera publike, sepse ishte vënë re dëmtimi i shëndetit të pirësve pasivë. Duhanpirësit protestuan se kjo ishte një persekutim dhe kufizim i lirisë së tyre. Kush ka të drejtë? A është i justifikuar kufizimi i lirive të duhanpirësve?</p>

5. Për të pakësuarnivelet e rrezikshme të ndotjes dhe për të shmangur ndërtimin e rrugëve të reja, qeveria e një bashkie të madhe vendosi të përcaktonte rregulla të reja sipas të cilave makinat u pajisen me leje qarkullimi me ngjyrë të kuqe ose blu. Në një ditë lejoheshin të lëviznin në rrugët e qytetit vetëm makinat me leje qarkullimi të kuqe dhe ditën tjetër ato me leje qarkullimi blu. Shumë shoferë protestuan se rregulla të tilla i kufizonin liritë e tyre dhe se ata nuk mund të detyroheshin të përdornin transportin publik.

A është i justifikueshëm ky kufizim?

6. Me shtimin e dhunës dhe vrasjeve me armët e gjahut qeveria vendosi të fillonte një system licënsimi të armëve shumë strict, duke vënë çmimke shumë të larta. Efekti i kësaj do të ishte se shumica e njerëzve nuk do të ishin në gjendje të përballonin mbajtjen e një arme. Zotëruesit e armëve e quajtën këtë vendim një dhunim të lirisë për të patur një armë për të gjuajtur ose në qoftë se do të ishte e nevojshme për t'u vetëmbrojtur. Qeveria thoshte se në këtë rast liritë individuale duhet të kufizohen në mënyrë që të kemi një shoqëri më të sigurtë.

Kush ka të drejtë?

Zbulimi i thesarit (lojë)

Qëllimi: Të argëtohen nxënësit përmes lojërave të shkathtësisë që lidhen me aftësitë gjuhësore të tyre.

Mjete të nevojshme: letra të mëdha, një dhuratë simbolike.

Zhvillimi i veprimtarisë

Mësuesi sjell në klasë një objekt të cilin në këtë veprimtari do ta trajtojnë si "thesar". Ai përpiqet të trajtojë si "thesar" një send që ka lidhje me natyrën, si p.sh. bimë, lule, kafshë, etj.

1. Nxirren jashtë klasës nxënësit që duan të luajnë lojën e "thesarit". Mësuesi e ka fshehur në një vend objektin dhe nxënësit që dolën jashtë nuk e dinë se ku.
2. Vendosen në mur tabakë letre të mëdha ku janë shkruar fragmente shkronjash të cilat po t'i bashkosh tregojnë vendin ku fshihet "thesari".
3. Ftohen nxënësit të vijnë brenda dhe me shpejtësi të bashkojnë (me mend) fragmentet e shkronjave dhe të gjejnë vendin ku fshihet "thesari". Kush e gjen i pari fiton dhe dhuratën e bërë nga etë fëmijët për fituesin.

